

HYRJE

Të nderuar kolegë, partnerë, anëtarë të AAPSK-së dhe lexues të këtij raporti,

Është një nder i veçantë për mua t'ju paraqes raportin vjetor të punës dhe arritjeve të institucionit tonë. Ky dokument nuk është thjesht një përmbledhje statistikash apo aktiviteteve, por një pasqyrë e përkushtimit, vizionit dhe energjisë që secili prej nesh në Agjenci ka dhënë në funksion të misionit tonë të përbashkët.

Konteksti dhe rëndësia

Viti që lamë pas ka qenë i mbushur me sfida, por edhe me mundësi të reja. Në një periudhë ku dinamika sociale dhe ekonomike ndryshon me ritme të shpejta, AAPSK ka ditur të ruajë stabilitetin institucional dhe të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për anëtarët e saj. Raporti vjetor përfaqëson një dëshmi të qartë të përpjekjeve tona për të qenë një institucion i besueshëm, transparent dhe i qëndrueshëm.

Ky dokument reflekton jo vetëm punën e përditshme, por edhe strategjitë afatgjata që kemi ndjekur për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe për të përmbushur objektivat tona institucionale.

Arritjet kryesore

- Konsolidimi i strukturave organizative dhe rritja e transparencës.
- Zhvillimi i projekteve të reja me ndikim pozitiv në komunitet.
- Forcimi i partneriteteve me institucione vendore dhe ndërkombëtare.
- Mbështetja e anëtarëve përmes trajnimeve, seminareve dhe aktiviteteve profesionale.

Këto arritje janë rezultat i punës së palodhur të secilit prej jush dhe dëshmi e fuqisë së bashkëpunimit institucional.

Mesazhi për të ardhmen

Ndërsa prezantojmë këtë raport, është e rëndësishme të shohim përpara me optimizëm dhe vendosmëri. Sfida të reja na presin, por me përvojën dhe energjinë që kemi, jam e bindur se do t'i përballojmë me sukses.

AAPSK do të vazhdojë të jetë një platformë e fortë bashkëpunimi, inovacioni dhe zhvillimi profesional. Ky raport është një ftesë për secilin prej nesh që të angazhohet më tej, të sjellë ide të reja dhe të kontribuojë në misionin tonë të përbashkët.

Të nderuar kolegë, partnerë, publik i gjerë dhe dashamirës, ky mesazh është një reflektim mbi rrugëtimin tonë të përbashkët dhe një thirrje për të ardhmen. Ju falënderoj për përkushtimin,

energjinë dhe besimin që keni treguar. Le të ecim përpara së bashku, me vizion të qartë dhe vendosmëri, për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për AAPSK-në dhe komunitetin tonë.

PREAMBUL

Me kënaqësi dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie institucionale ju paraqesim Raportin Vjetor të Analizës së Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK), i cili pasqyron punën, sfidat, arritjet dhe orientimet strategjike të institucionit tonë gjatë periudhës raportuese.

Ky raport nuk përfaqëson vetëm një detyrim ligjor dhe administrativ, por mbi të gjitha është një instrument transparence, llogaridhënieje dhe reflektimi profesional, përmes të cilit AAPSK demonstroi përkushtimin e saj ndaj sundimit të ligjit, forcimit të integritetit institucional dhe mbrojtjes së interesit publik.

Roli dhe misioni institucional

AAPSK, si një institucion kyç në sistemin e drejtësisë dhe administrimit publik, ka një rol të pazëvendësueshëm në administrimin efikas, të ligjshëm dhe transparent të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Administrimi i kësaj pasurie nuk është vetëm një proces teknik apo financiar; ai përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe veprave të tjera penale, duke siguruar që përfitimet e paligjshme të mos shndërrohen në burime fuqizimi për aktivitetet kriminale, por të vihen në funksion të interesit publik.

Misioni i AAPSK-së mbetet i qartë: garantimi i ruajtjes së vlerës së pasurisë, menaxhimi profesional i saj dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore në mënyrë të paanshme, efikase dhe të besueshme.

Analiza e periudhës raportuese

Periudha e mbuluar nga ky raport ka qenë dinamike dhe sfiduese, e karakterizuar nga rritja e numrit dhe kompleksitetit të rasteve, zhvillimet në kornizën ligjore dhe pritshmëritë në rritje të publikut për transparencë dhe efikasitet.

Gjatë kësaj periudhe, AAPSK ka punuar në mënyrë të vazhdueshme për:

- përmirësimin e procedurave të brendshme të administrimit të pasurisë;
- forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit;
- rritjen e bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë dhe organet e zbatimit të ligjit dhe partnerët relevantë;
- avancimin e sistemeve të raportimit dhe dokumentimit;
- rritjen e nivelit të transparencës publike.

Raporti ofron një pasqyrë të detajuar mbi strukturën e pasurive të administruara, mënyrat e menaxhimit, rezultatet financiare, sfidat operative dhe masat e ndërmarra për adresimin e tyre.

Transparenca dhe llogaridhënia

Transparenca është një nga parimet themelore të punës së AAPSK-së. Ky raport përbën një dëshmi konkrete të përkushtimit tonë për komunikim të hapur me publikun, institucionet mbikëqyrëse dhe partnerët.

Llogaridhënia nuk kufizohet vetëm në raportimin e shifrave, por përfshin analizën kritike të proceseve, identifikimin e dobësive dhe përcaktimin e objektivave të qarta për përmirësim të vazhdueshëm.

Në këtë frymë, raporti paraqet jo vetëm sukseset, por edhe sfidat reale me të cilat është përballur institucioni, duke ofruar rekomandime dhe orientime për të ardhmen.

Zhvillimi institucional dhe burimet njerëzore

Kapaciteti institucional i AAPSK-së lidhet drejtpërdrejt me profesionalizmin dhe integritetin e stafit. Gjatë periudhës raportuese është investuar në zhvillimin profesional të burimeve njerëzore, përmes trajnimeve, rritjes së njohurive teknike dhe forcimit të kulturës së përgjegjësisë institucionale dhe etikës.

Janë ndërmarrë gjithashtu hapa drejt modernizimit të proceseve të punës, standardizimit të procedurave dhe përmirësimit të koordinimit të brendshëm, me synimin për të rritur efikasitetin operacional dhe cilësinë e shërbimeve.

Perspektiva dhe orientimet e së ardhmes

AAPSK mbetet e përkushtuar në:

- avancimin e mëtejshëm të kornizës institucionale dhe procedurale;
- harmonizimin me praktikrat dhe standardet evropiane;

- rritjen e përdorimit të teknologjisë në administrimin e pasurisë;
- forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar;

ndërtimin e besimit të qëndrueshëm publik ndaj rolit dhe funksionit të institucionit.

Ky raport shërben si bazë analitike për planifikimin strategjik dhe orientimin e veprimeve të ardhshme, duke reflektuar vullnetin e AAPSK-së për përmirësim të vazhdueshëm dhe përbushje të mandatit të saj ligjor.

NDRYSHIMET STRUKTURE NË AAPSK

Përshkrimi i ndryshimeve strukturore

Në zbatim të Urdhrit nr. 163, datë 25.9.2025 të Kryeministrit, janë realizuar ndryshime të rëndësishme në strukturën dhe organikën e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK). Këto ndryshime kanë sjellë një rritje të ndjeshme të kapaciteteve institucionale dhe administrative të Agjencisë, duke kaluar nga 14 punonjës në një total prej 36 punonjësish, punonjës këto të cilët do të kenë statusin e nëpunësit civil.

1. Rritja e numrit të punonjësve

- Nga një strukturë e kufizuar me 14 punonjës, organika është zgjeruar tashmë në 36 pozicione të miratuara.
- Rritja synon përballimin e ngarkesës së shtuar të punës, si rezultat i zgjerimit të objektit të ligjit dhe administrimit të pasurive të reja.

2. Struktura e re organizative

Për herë të parë këtë vit, institucioni u organizua në nivel **drejtorie dhe sektorë të rinj**, të cilët konsolidojnë funksionet e Agjencisë:

- **Kryeadministratori** – drejtuesi i përgjithshëm i Agjencisë.
- **Drejtoria e Administrimit të Pronës (10 punonjës)**
 - Sektori i marrjes në dorëzim dhe kontrollit fizik/monitorimit të pasurive & provave materiale (5 punonjës).
 - Sektori i shitjes dhe qirasë (4 punonjës).
- **Drejtoria e Trajtimit të Ankesave, Marrëdhënieve me Institucionet dhe Çështjeve Juridike (9 punonjës)**

- Sektori i trajtimit të ankesave dhe marrëdhënieve me institucionet (2 punonjës).
- Sektori i çështjeve gjyqësore (3 punonjës).
- **Drejtoria e Projekteve dhe Marrëveshjeve (6 punonjës)**
 - Sektori i projekteve (3 punonjës).
 - Sektori i marrëveshjeve (2 punonjës).
- **Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (12 punonjës)**
 - Sektori i financës (3 punonjës).
 - Sektori i shërbimeve mbështetëse (8 punonjës).

3. Efektet e ndryshimeve

- *Forcim i kapaciteteve institucionale:* rritja e numrit të punonjësve dhe krijimi i sektorëve të specializuar siguron një administrim më profesional dhe të plotë të pasurive të sekuestruara/konfiskuara.
- *Unifikim i përgjegjësi:* çdo fazë e procesit (marrja në dorëzim, ruajtja, shitja, qiraja, trajtimi i ankesave, çështjet gjyqësore) është e mbuluar nga struktura e re.
- *Rritje e transparencës dhe efikasitetit:* ndarja e qartë e funksioneve shman mbivendosjen e kompetencave dhe vonesat burokratike.
- *Përputhje me standardet e administratës publike:* të gjithë punonjësit janë të kategorizuar si nëpunës civilë, duke garantuar profesionalizëm dhe stabilitet institucional.

4. Përfundim

Ky ndryshim nga **14 në 36 punonjës** përfaqëson një **zgjerim strategjik** të AAPSK-së, duke e kthyer atë në një strukturë më të fuqishme, të aftë për të përballuar sfidat e reja ligjore dhe administrative. Me këtë organikë të re, Agjencia është më e përgatitur për të realizuar misionin e saj ligjor: administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në mënyrë transparente, efikase dhe në shërbim të interesit publik.

INICIATIVAT LIGJORE TË AAPSK-së

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarë një sërë nismash ligjore nga AAPSK, të cilat kanë synuar përmirësim të funksioneve dhe pozicionim të rëndësishëm që ky institucion meriton, kryesisht si më poshtë :

1. Me Urdhrin e MB Nr.1 datë 07.01.2025 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e AAPSK”, institucioni hartoi dhe miratoi për herë të parë rregulloren e brendshme të tij;
2. U ndryshua struktura organizative e AAPSK sipas Urdhrit të KM Nr.163 datë 25.09.2025;
3. Janë propozuar ndryshimet ligjore për Ligjin Nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, i cili aktualisht ka përfunduar fazën e konsultimit publik;
4. Janë propozuar ndryshimet ligjore për Ligjin Nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si objekte pa leje”, i cili aktualisht ka përfunduar fazën e konsultimit publik;
5. Është propozuar ndryshimi i kategorisë së institucionit, nga kategoria e IV në kategorinë e III për faktin e riskut, vështirësive që lindin si rezultat i aktivitetit të menaxhimit të pasurive, të ardhura nga veprimtaritë kriminale dhe impakti që institucioni ka sjellë tek institucione të tjera në fonde dhe të mira materiale.

Referuar dy iniciativave më të rëndësishme ligjore, ju paraqesim një përshkrim të përmbledhur rreth tyre.

I. Konteksti i Përgjithshëm

Gjatë vitit raportues, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) ka intensifikuar rolin e saj si institucion qendror në hartimin dhe promovimin e ndryshimeve ligjore që lidhen me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Këto iniciativa janë ndërmarrë në kuadër të reformave të vazhdueshme për forcimin e transparencës, eficiencës dhe rikthimit të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme në shërbim të komunitetit dhe interesit publik.

II. Projektligji për ndryshime në Ligjin nr. 34/2019

AAPSK ka hartuar dhe propozuar projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar. Ky projektligj ka synuar:

- **Zgjerimin e objektit të ligjit** duke përfshirë jo vetëm pasuritë e sekuestruara nga organet e drejtësisë, por edhe ato të konfiskuara nga pushteti vendor dhe organet administrative, përfshirë ndërtimet pa leje.
- **Përfshirjen e pasurive të reja** si kriptomonedhat (monedhat virtuale), duke përcaktuar rregulla të posaçme për administrimin e tyre.

- **Transferimin e kompetencave të shitjes** së pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara tek vetë Agjencia, duke shmangur vonesat burokratike dhe duke rritur efikasitetin financiar.
- **Rritjen e kapaciteteve institucionale** për menaxhimin e ciklit të plotë të pasurisë, nga sekuestrimi deri në shitje dhe transferim të të ardhurave.

Ky projektligj ka synuar të forcojë mbrojtjen e interesave publike dhe të sigurojë një administrim më të shpejtë, transparent dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara/konfiskuara.

III. Projektligji për ndryshime në Ligjin nr. 66/2023

Në vijim të reformave, AAPSK ka hartuar dhe propozuar projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social”. Ky projektligj synon të sjellë:

- **Centralizimin e kompetencave** pranë AAPSK-së, duke e përcaktuar si organ unik përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e objekteve të konfiskuara.
- **Krijimin e Grupit të Punës** si strukturë e përhershme teknike për vlerësimin e gjendjes juridike, teknike dhe financiare të objekteve.
- **Ngritjen e Regjistrit të Objekteve të Konfiskuara**, për të garantuar transparencë dhe akses nga publiku.
- **Thjeshtimin e procedurave ligjore dhe teknike**, përfshirë dhënien e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe rregullimin e procedurave të shitjes përmes ankandit publik.
- **Përcaktimin e qartë të përgjegjësiave ligjore dhe financiare** të subjekteve zhvilluese, zbatuese dhe mbikëqyrëse pas konfiskimit.
- **Krijimin e fondit të posaçëm për ndërtimet pa leje**, i dedikuar për zhvillimin dhe përdorimin e objekteve të konfiskuara.

Ky projektligj ka adresuar problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, si fragmentimi i kompetencave, mungesa e transparencës dhe vështirësitë në financim, duke ofruar një model të ri të qartë, efikas dhe të qëndrueshëm.

IV. Efektet e Pritshme

Nga zbatimi i këtyre dy projektligjeve, pritet:

- Rritja e të ardhurave për buxhetin e shtetit dhe fondet e posaçme.
- Shmangia e vonesave burokratike dhe konflikteve ndërinstitutionale.

- Forcimi i transparencës dhe sigurisë juridike për pronarët dhe institucionet.
- Rikthimi më i shpejtë dhe më i drejtë i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme në shërbim të komunitetit.
- Rritja e efikasitetit të AAPSK-së si institucion qendror në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

V. Përfundim

Iniciativat ligjore të ndërmarra nga AAPSK gjatë vitit raportues përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të kuadrit ligjor dhe forcimit të rolit të Agjencisë si garant i interesit publik. Përmes këtyre ndryshimeve, AAPSK ka konsoliduar pozicionin e saj si institucion unik dhe profesional në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, duke siguruar një menaxhim më të drejtë, më transparent dhe më efikas në shërbim të shtetit dhe shoqërisë.

PROBLEMATIKAT QË KËRKOJNË ADRESIM

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) ka një rol thelbësor në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përmes administrimit efikas, transparent dhe të ligjshëm të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e drejtësisë. Megjithëse janë bërë përparime të rëndësishme në konsolidimin e funksioneve të saj, praktika e përditshme ka evidentuar një sërë sfidash strukturore, ligjore dhe operationale që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e Agjencisë.

Ky material paraqet problematikat kryesore që kërkojnë adresim, si dhe masat konkrete që duhet të ndërmerren për rritjen e efektivitetit, profesionalizmit dhe besueshmërisë së AAPSK.

Problemikat e Evidentuara

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, AAPSK ka identifikuar disa problematika që ndikojnë në cilësinë dhe efikasitetin e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara:

- **Fragmentimi i kompetencave ndër-institucionale** — përfshirja e disa institucioneve në proces ka sjellë vonesa, mbivendosje funksionesh dhe mungesë koordinimi.
- **Mungesa e procedurave të unifikuara** — afatet ligjore dhe praktikët e ndryshme institucionale krijojnë paqartësi dhe ngadalësojnë proceset.

- **Procedura të gjata dhe të ndërlikuara** për kalimin e pasurive nga statusi i sekuestrimit në konfiskim.
- **Mospërputhje ndërmjet ligjit për AAPSK dhe legjislacionit penal, procedural dhe fiskal** — shoqëri tregtare që nuk mund të pezullohen apo mbyllen për shkak të detyrimeve të akumuluar; pasuri të paluajtshme me mbivendosje në regjistrat kadastralë ose të paregjistruara, prona të cilat nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar të cilat nuk mund të destinohen apo të futen në qarkullim civil. Këto lloj problematikash sjellin akumulim të kostove të mirëmbajtjes përgjatë kohës së administrimit të tyre nga AAPSK.
- **Administrimi i tipologjive të reja të pasurive** — si kriptomonedhat apo ndërtimet pa leje, të cilat paraqesin sfida të reja teknike dhe ligjore.
- **Mungesa e transparencës së plotë** — mungesa e një regjistri elektronik publik kufizon aksesin e institucioneve dhe qytetarëve në informacion.
- **Kapacitete të kufizuara institucionale** — numri aktual i punonjësve dhe struktura organizative nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar ngarkesën në rritje.
- **Fonde të destinuar jo në llogaritë përkatëse** — kalimi i fondeve në buxhetin e shtetit ka krijuar vështirësi në përfundimin procedurave të ekzekutimit dhe në mbulimin e shpenzimeve të menjëhershme.
- **Mungesë përgjegjësie të subjekteve zhvilluese pas sekuestrimit/konfiskimit** — boshllëqe ligjore në përcaktimin e detyrimeve për përfundimin e punimeve të mbetura në objektet e sekuestruara / konfiskuara, të cilat më pas nuk mund të administrohen me qëllim gjenerim të ardhurash.
- **Nevojë për specializim të mëtijshëm** në fusha si vlerësimi i pasurive, menaxhimi financiar, administrimi i bizneseve dhe pasurive komplekse.
- **Vështirësi në administrimin e pasurive me kosto të lartë mirëmbajtjeje** — ndërtesa, mjete, biznese aktive etj.
- **Rrezik zhvlerësimi të pasurive** për shkak të vonësive procedurale ose mungesës së strategjive të përdorimit të përkohshëm.
- **Mungesë infrastrukture të përshtatshme për ruajtjen e pasurive** — shërbimet e ruajtjes kanë kosto të larta dhe risku gjithashtu i ruajtjes është i lartë si prej faktorëve kohë, apo dhe faktorëve të demtimit të qëllishëm apo humbjes së vlerës.
- **Perceptim publik i kufizuar mbi rolin real të AAPSK** — publiku shpesh e lidh veprimtarinë e Agjencisë vetëm me shitjen e pasurive, duke krijuar pritshmëri të pasakta dhe perceptime negative mbi transparencën e procedurave, pavarësisht sqarimeve të

vazhdueshme institucionale, ku jemi përpjekur të sqarojmë procedurat dhe prioritet mbi këto asete, mbetet ende punë në progresion për t'u kryer.

Masat e Nevojshme për Përmirësim

Për të adresuar këto problematika dhe për të rritur performancën institucionale, AAPSK ka propozuar dhe po zbaton një sërë masash:

- **Centralizimi i kompetencave** pranë AAPSK, duke e përcaktuar si organ unik përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.
- **Krijimi i strukturave të përhershme teknike**, përfshirë Grupin e Punës për vlerësimin e objekteve, për të garantuar standarde të unifikuara dhe profesionalizëm.
- **Ngritja e Regjistrimit të Pasurive të Konfiskuara**, për të rritur transparencën dhe aksesin publik.
- **Thjeshtimi i procedurave ligjore dhe teknike**, me përshtatje të afateve dhe eliminim të burokracive të panevojshme.
- **Rritja e kapaciteteve institucionale**, duke zgjeruar organikën nga 14 në 36 punonjës me status nëpunësi civil.
- **Hartim të programeve të menaxhimit të riskut.**
- **Forcimi i rolit të AAPSK** në proceset e shitjes dhe dhënies me qira të pasurive, për të reduktuar vonesat dhe për të rritur të ardhurat publike.
- **Trajnime të vazhdueshme profesionale** në bashkëpunim me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.
- **Skema motivuese për ruajtjen e stafit të kualifikuar.**
- **Modernizimi i administrimit të pasurive**, përfshirë:
 - strategji për menaxhim aktiv të pasurive që gjenerojnë të ardhura,
 - përdorimin e teknologjisë për inventarizim, monitorim dhe raportim në kohë reale.
- **Takime periodike koordinuese** për trajtimin e rasteve komplekse.
- **Publikim periodik i raporteve të detajuara** mbi pasuritë e administruara dhe të ardhurat e gjeneruara.

- **Rritja e komunikimit publik** përmes kanaleve zyrtare, mediave dhe aktiviteteve informuese.
- **Përfshirja e shoqërisë civile dhe institucioneve të pavarura** në monitorimin e veprimtarisë së Agjencisë.

Përfundim


AAPSK, përmes reformave ligjore dhe organizative, po konsolidon rolin e saj si institucioni qendror dhe unik për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Masat e ndërmarra synojnë të garantojnë një administrim më transparent, më efikas dhe më të drejtë, duke rikthyer pasuritë e përfituara në mënyrë të paligjshme në shërbim të komunitetit dhe interesit publik.

Përmirësimi i mëtejshëm i punës dhe performancës së AAPSK kërkon një qasje të integruar që kombinon reforma ligjore, forcim institucional, profesionalizëm dhe transparencë. Vetëm përmes adresimit të këtyre problematikave dhe zbatimit të masave konkrete, Agjencia mund të përmbushë plotësisht misionin e saj dhe të kontribuojë në mënyrë të qëndrueshme në forcimin e shtetit të së drejtës dhe rritjen e besimit publik.

PERFORMANCA MBI ADMINISTRIMIN E PASURIVE, AAPSK 2025

Të ardhura nga qiratë krahasuar me vitin paraardhës

Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2025	14,546,477.0	15,129,132.00	19,571,106.00	18,263,054.00	14,120,036.00	18,220,113.00
2024	8,434,728.47	8,252,462.00	7,745,539.00	11,350,656.00	12,500,110.00	10,137,773.00
Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Vjetor
20,180,200.00	19,093,612.00	22,379,854.00	18,167,219.00	18,630,497.00	23,205,276.00	221,506,576.00
16,212,121.00	19,801,472.00	15,047,216.00	16,182,621.00	17,823,761.00	15,681,996.00	159,170,455.47



Të ardhurat e realizuara nga interesat bankare arritën në total 1,300, 000 Euro për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 ku totali ishte 630,000 Euro, pra 106.35% më tepër se viti i kaluar dhe 700,000 euro vijnë depozitë për periudhën në vijim (viti 2026).

Kontratat e qirasë sipas viteve:

Pasuritë e dhëna me qira dhe të ardhurat nga qeratë në vite		
Vitet	Numuri i pasurive të dhëna me qira	Të ardhurat nga qeratë në lekë
2022	170	74,981,046
2023	198	78,902,024
2024	282	159,170,455
2025	344	221,506,575

TË DHËNAT E PERFORMANCËS SË AAPSK PËR VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) ka realizuar një sërë rezultatesh të rëndësishme në administrimin, përdorimin dhe destinimin e pasurive nën administrim, si në aspektin financiar ashtu edhe në atë operacional.

Të ardhurat dhe kontributi financiar

- **221,506,575 lekë të ardhura** të gjeneruara vetëm nga qiraja e pasurive të administruara. Trendi i theksuar rritës vijon dhe tashmë synojmë të sfidojmë veten, duke krahasuar jo vetëm të ardhurat për vitet 2023-2024, por edhe vitet 2024-2025.

- **11,844,519 euro** të derdhura në buxhetin e shtetit dhe në financimin e projekteve të institucioneve të hetimit.
- **67,500,000 lekë** të alokuara për institucione të tjera shtetërore, sipas vendimmarrjes ligjore dhe procedurale.

Destinimi i pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme

- **4 pasuri të paluajtshme** janë kaluar në pronësi të institucioneve shtetërore.
- **2 pasuri** janë vënë në **ripërdorim social**, në funksion të komunitetit dhe interesit publik.
- **26 automjete** janë kaluar në pronësi të institucioneve shtetërore.
- **6 automjete** janë vënë në përdorim operacional.
- **27 automjete** janë dhënë me qira, pasi vijojnë të jenë objekt hetimi dhe nuk mund të destinohen përfundimisht.

Proceset në zhvillim

- Në proces ankandi ndodhen rreth **15,000 automjete të klasifikuara si skrap**, të mbledhura nga strukturat e Policisë së Shtetit.
- Po kryhet vlerësimi i rreth **10,000 automjeteve** të tjera, të cilat do të shiten për pjesë këmbimi.
- **Parashikimi financiar**: vetëm nga këto procese pritet të gjenerohen rreth **2 milionë euro** të ardhura.

STATISTIKA MBI INVENTARIN E PASURIVE DHE PROVAVE MATERIALE

Sipas raportimeve të administratorëve të pasurive deri në dhjetor 2025

- Pasuritë dhe provat materiale të administruara nga AAPSK, sipas vendimeve gjyqësore deri më **31.12.2025**, përfshijnë të gjitha kategoritë e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, të cilat janë në proces administrimi, destinimi ose shitjeje.

Pasuri/Prova materiale sipas vendimeve gjyqësore deri më 31.12.2025:

<i>Pasuri/Prova materiale sipas vendimeve gjyqësore</i>		
<i>Nr.</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Total</i>
1	Pasuri/ Prova materiale sipas vendimeve	3982

2	Pasuri/ Prova materiale të marra në dorëzim	2890
3	Pasuri/ Prova materiale të pa marra në dorëzim	1092

Pasuri/Prova materiale në administrim të AAPSK-së deri më 31.12.2025:

<i>Pasuri në administrim të AAPSK</i>		
<i>Nr</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Total</i>
1	Sekuestruara (së bashku me asetet e subjekteve tregtare të përmendura në dispozitivin e gjykatës)	1679
2	Konfiskuara	488
3	Prova materiale	665
4	Llogari/shuma monetare të konfiskuara të arkëtuara në llogari të dedikuara të AAPSK	58
TOTAL		2890

Pasuri/Prova materiale në administrim të AAPSK-së sipas llojit deri më 31.12.2025:

<i>Pasuri në administrim të AAPSK sipas llojit</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Kategoria</i>	<i>Përshkrimi</i>		<i>Total</i>
1	Të paluajtshme	Apartamente/Ndërtesa/Objekte/Parkim/Garazh	Sekuestruara	612
			Konfiskuara	287
		Toka Truall/Arë/Pyje/Kullota	Sekuestruara	141
			Konfiskuara	140
2	Te luajtshme	Automjete/Mjete motorike	Sekuestruara	118
			Konfiskuara	28

3	Subjekte tregtare (Person fizik/juridik) / Asete të subjektit tregtar	Sekuestruara	178
		Konfiskuara	26
4	Llogari bankare/Shuma monetare	Sekuestruara	630
		Konfiskuara	65
5	Prova materiale	Sekuestruara/ Konfiskuara	665
TOTAL			2890

Pasuritë në administrim të AAPSK-së sipas llojit për periudhën Janar 2025 – Dhjetor 2025:

<i>Pasuri në administrim të AAPSK sipas llojit</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Kategoria</i>	<i>Përshkrimi</i>		<i>Total</i>
1	Të paluajtshme	Apartamente/Ndertesa/Objekte/ Parkim/Garazh	Sekuestruara	280
			Konfiskuara	14
		Toka Truall/Are/Pyje/Kullota	Sekuestruara	70
			Konfiskuara	34
2	Të luajtshme	Automjete/Mjete motorike	Sekuestruara	25
			Konfiskuara	2
3	Subjekte tregtare (Person fizik/juridik)/ /Asete të subjektit tregtar		Sekuestruara	47
			Konfiskuara	0
4	Llogari bankare/Shuma monetare		Sekuestruara	304
			Konfiskuara	14
5	Prova materiale		Sekuestruara/Konfiskuara	421

TOTAL	1211
--------------	-------------

Përmbledhëse vjetore në administrim të AAPSK

Pasuri në administrim të AAPSK sipas llojit dhe vlerës për periudhën Janar 2025 - Dhjetor 2025					
Nr.	Kategoria	Përshkrimi		Total	Vlera në lekë
1	Të paluajtshme	Apartamente/Ndërtesa/Objekte/ Parkim/Garazh	Sekuestruara	280	4,332,110,322.60
			Konfiskuara	14	90,220,290.00
		Toka Truall/Arë/Pyje/Kullota	Sekuestruara	70	739,041,538
			Konfiskuara	34	56,894,661
2	Të luajtshme	Automjete/Mjete motorike	Sekuestruara	25	42,340,240.00
			Konfiskuara	2	1,900,000.00
3	Subjekte tregtare (Person fizik/Juridik)/ /Asete te Subjektit tregtar		Sekuestruara	47	pa vlere
			Konfiskuara	0	0
4	Llogari bankare/Shuma monetare		Sekuestruara	304	772,341,333.09
			Konfiskuara	14	31,655,077.80
5	Prova materiale		Sekuestruara/Konfiskuara	421	128,919,471.00
TOTAL				1,211	6,195,422,933.49

Nr.	Pasuri në administrim gjatë 2025	Total	Vlera në lekë
1	Sekuestruar	726	5,885,833,433.69
2	Konfiskuar	64	180,670,028.80
3	Prova materiale	421	128,919,471.00
		1,211	6,195,422,933.49

Nr.	Emërtimi	Nr.Fizik	Vlerësimi i përafërt në lekë	Vlerësimi i përafërt në euro 1 euro= 96.27 lekë	Pasuritë pa vlerësim nr.fizik
1	Pasuritë e sekuestruara TOTAL në dt.31.12.2025	1,679	13,096,277,936.48	136,036,957.89	441
2	Pasuritë e konfiskuara TOTAL në dt.31.12.2025	546	4,965,728,883.72	51,581,270.22	11
3	Pasuritë prova materiale TOTAL në dt.31.12.2025	665	1,909,921,551.18	19,839,218.36	308
4	Pasuritë e sekuestruara vetëm gjatë vitit 2025	726	5,885,833,433.69	61,138,812.03	133
5	Pasuritë e konfiskuara vetëm gjatë vitit 2025	64	180,670,028.00	1,876,701.24	4
6	Pasuritë prova materiale vetëm gjatë vitit 2025	421	128,919,471.00	1,339,144.81	160
7	Pasuritë e revokuara vetëm gjatë vitit 2025	65	402,589,693.00	4,181,881.09	22
Ps. Në pasuritë pa vlerësim hyn: 1-pasuri në proces legalizimi, 2-pasuri në proces vlerësimi, 3-llogari bankare me balancë 0 ose me balancë negative. Kursi i euros është marrë nga BSH dt.31.12.2025.					

Pasuritë e pamarra ende në dorëzim

(Arsyet e përgjithshme sipas raportimeve të administratorëve të pasurive janë)

Procesi i marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara vijon të përballët me një sërë pengesash të natyrës ligjore, administrative dhe faktike. Bazuar në komentet dhe raportimet e administratorëve të pasurive, arsyet kryesore janë përmbledhur si më poshtë:

1. Pasuritë e paluajtshme

Pjesa më e madhe e pasurive të paluajtshme nuk janë dorëzuar nga Oficerët e Policisë Gjyqësore pranë SPAK, DPPSH apo Drejtorive Vendore të Policisë, për shkak të:

- pranisë së familjarëve që banojnë në këto pasuri dhe që nuk disponojnë një banesë alternative;
- pasaktësi në të dhënat kadastrale, vështirësi identifikimi;
- vështirësive praktike në ekzekutimin e vendimeve të gjykatës.

Administratorët e pasurive kanë paraqitur kërkesa zyrtare për bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, me qëllim realizimin e ekzekutimit dhe marrjen në dorëzim të pasurive.

2. Pasuritë e luajtshme (mjete motorike)

Një pjesë e konsiderueshme e mjeteve motorike nuk janë dorëzuar nga Oficerët e Policisë Gjyqësore pranë DPPSH apo drejtorive vendore të Policisë, pasi:

- mjetet nuk janë gjetur në vendndodhjet e identikuara;
- mjetet janë shpallur në kërkim nga Policia e Shtetit;
- ekzistojnë dyshime për fshehje apo largim të qëllimshëm të mjeteve.

3. Pasuritë e llojit “Shoqëri Tregtare”

Shoqëritë tregtare të sekuestruara apo të konfiskuara nuk janë dorëzuar në administrim kryesisht për shkak të:

- pamundësisë për të identifikuar selinë e tyre zyrtare;
- mungesës së informacionit mbi vendin real të ushtrimit të aktivitetit;
- mospërputhjeve ndërmjet të dhënave në QKB dhe situatës faktike në terren.

Këto rrethana e bëjnë të pamundur marrjen në dorëzim dhe administrimin efektiv të tyre.

4. Totali i pasurive të pamarra në dorëzim

Numri total i pasurive dhe provave materiale që nuk janë marrë ende në dorëzim nga AAPSK është:

- **1,092 pasuri/prova materiale**

Ky numër përfshin pasuri të paluajtshme, mjete motorike, shoqëri tregtare dhe kategori të tjera pasurish të cilat, për arsyet e mësipërme, nuk kanë kaluar ende në administrimin e Agjencisë.

TREGUESIT FINANCIAR

Raportimi mbi gjendjen dhe realizimin e treguesve financiarë për vitin 2025 dhe parashikimi për vitin 2026

Në kuadër të raportimit të performancës financiare të AAPSK për vitin 2025 dhe parashikimit të treguesve për vitin 2026, paraqiten të dhënat e detajuara si më poshtë:

Planifikimi i të ardhurave sipas strukturës për vitin 2026

Nr.	Lloji i të ardhurave	Të ardhurat viti 2025 (lekë)	Parashikimi viti 2026 (lekë)
1	Të ardhura nga pasuritë e dhëna me qira	221,506,575	250,000,000
2	Të ardhura nga interesat bankare (650,000 euro të konvertuara në lekë, të kaluara në rezultatin financiar të vitit 2025)	62,075,000	60,000,000
3	Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme me ankand	4,834,054	49,870,000
4	Të ardhura nga mbajtja e shpenzimeve për pasuritë e revokuara me vendime gjyqësore	322,970	500,000
5	Të ardhura me vendim të KNMKKO për vazhdimin e aktivitetit të AAPSK në vitin 2026	20,000,000	20,000,000
Totali		308,738,599	380,370,000

Projektet e financuara në vitin 2025

Sipas vendimeve të Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar (KNMKKO)

Nr.	Institucioni i financiar	Shuma e projektit	Shuma financuar	Data e likuidimit
1	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Qendra e Furnizimit Materialo-Teknik)	300,000 euro	–	–
2	Prokuroria e Përgjithshme	15,000,000 lekë	15,000,000 lekë	04.07.2025
3	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	26,700,000 lekë	26,700,000 lekë	03.10.2025
4	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	5,000,000 lekë	5,000,000 lekë	03.10.2025

Nr.	Institucioni i financiar	Shuma e projektit	Shuma e financiar	Data e likuidimit
5	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	740,195 euro	–	23.06.2025
6	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	16,305,380 lekë	16,305,380 lekë	30.10.2025
7	Kthimi në buxhetin e shtetit i vlerës së konfiskuar të shtetasit Francesco Zumo	10,000,000 euro	10,000,000 euro	Maj 2025
8	Investime për AAPSK	20,000,000 lekë	20,000,000 lekë	07.11.2025

Projektet e miratuara në KNMKKO dhe në proces financimi

Nr.	Institucioni	Kontrata	Shuma (euro)	Shuma (lekë)
1	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Nuk ka kontratë	–	119,000,000
2	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë	Vendimi nr. 5751, datë 19.11.2025	–	5,000,000
3	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	–	–	3,514,328
4	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Nr. 2166/3, datë 02.12.2025	100,000	–
5	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Nr. 5857, datë 26.11.2025 dhe nr. 5858, datë 06.11.2025	1,377,000	41,280,000
6	SPAK	Nuk ka kontratë	3,300,000	–
7	SPAK	Nuk ka kontratë	–	121,287,421

Nr.	Institucioni	Kontrata	Shuma (euro)	Shuma (lekë)
8	SPAK	Nuk ka kontratë	1,800,000	–

Projekte të tjera në proces

Për një pjesë të projekteve të tjera të institucioneve përfituese janë marrë vendime financimi dhe, në disa raste, janë lidhur kontratat përkatëse ndërmjet palëve. Financimi i tyre do të realizohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara.

Analiza e gjendjes financiare për vitin 2025 dhe parashikimi për vitin 2026

Dinamika e të ardhurave

Gjatë vitit 2025, të ardhurat totale të Agjencisë arritën në **308,738,599 lekë**, ndërsa për vitin 2026 parashikohet një rritje e konsiderueshme, duke u vlerësuar në **380,370,000 lekë**. Ky ndryshim përfaqëson një rritje prej **23.21%**, duke reflektuar zgjerimin e burimeve të të ardhurave dhe intensifikimin e aktiviteteve të Agjencisë.

- **Të ardhurat nga pasuritë e dhëna me qira** mbeten burimi më i qëndrueshëm i financimit, me një rritje të moderuar prej rreth 8% nga viti 2025 në 2026, duke konfirmuar stabilitetin e portofolit të pasurive të administruara.
- **Të ardhurat nga interesat bankare** shfaqin një nivel të qëndrueshëm, me rritje prej 106.35%, e lidhur me strukturën e depozitave dhe lëvizjet e normave të interesit.
- **Të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme me ankand** përbëjnë elementin më dinamik për vitin 2026, duke u rritur nga 4.8 milionë lekë në 49.3 milionë lekë. Kjo rritje reflekton intensifikimin e proceseve të shitjes së pasurive të konfiskuara (ku pritet të përfshihen dhe objektet e klasifikuara si ndërtime pa leje).
- **Të ardhurat nga mbajtja e shpenzimeve për pasuritë e revokuara** mbeten modeste, por tregojnë rritje të lehtë, duke reflektuar konsolidimin e praktikave ligjore dhe administrative.
- **Të ardhurat e miratuara me vendim të KNMKKO** për investime në AAPSK kapin vlerën 20,000,000 lekë, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme për funksionimin e brendshëm të Agjencisë.

Vlerësim analitik

Struktura e të ardhurave për vitin 2026 pritet të ndryshojë ndjeshëm. Ndërsa qiratë dhe interesat bankare mbeten burime të qëndrueshme, të ardhurat nga ankandet pritet të dominojnë totalin e të ardhurave. Kjo tregon një zhvendosje strategjike drejt burimeve të lidhura me administrimin aktiv të pasurive të konfiskuara, duke rritur rolin e Agjencisë në rikuperimin e vlerave ekonomike.

2. Financimet e realizuara në vitin 2025

Gjatë vitit 2025, me vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, u financuan projekte të rëndësishme për institucione kyçe të sistemit të drejtësisë dhe sigurisë publike.

- **Institucionet e drejtësisë** (Gjykata e Posaçme dhe Prokuroria e Përgjithshme) përfituan mbi **130 milionë lekë**, duke reflektuar prioritetin për forcimin e kapaciteteve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** u financua me **29,160,000 lekë**, duke mbështetur logjistikën dhe furnizimin materialo-teknik.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** përfitoi **16,305,380 lekë**, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të administrimit peritenciar.
- **Kalimi në buxhetin e shtetit i vlerës së konfiskuar të shtetasit Francesko Zumo**, në vlerën **10 milionë euro**, përbën një rast të veçantë që demonstroi efektivitetin e mekanizmave të konfiskimit.
- **Investimet për AAPSK** u mbështetën me **20,000,000 lekë**, duke siguruar kapacitete të reja për funksionimin e brendshëm.

Vlerësim analitik

Financimet e vitit 2025 tregojnë një orientim të qartë drejt forcimit të institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë, duke e pozicionuar AAPSK si një aktor kyç në mbështetjen e reformës në drejtësi. Shuma e konsiderueshme e kaluar në buxhetin e shtetit nga konfiskimet tregon rolin e Agjencisë në rikuperimin e pasurive të paligjshme dhe kontributin e saj në financat publike.

3. Financimet e planifikuara për vitin 2026

Për një pjesë të projekteve janë marrë vendime financimi dhe janë lidhur kontrata ndërmjet palëve. Financimi i tyre është planifikuar të realizohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, duke garantuar vijimësinë e mbështetjes për institucionet e drejtësisë dhe sigurisë.

Gjithashtu, nga fondi i posaçëm është planifikuar mbështetje financiare për organizata jofitimprurëse, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe vendimmarrjen e KNMKKO.

4. Përfundime

Analiza e treguesve financiarë tregon se:

- **Të ardhurat nga qiratë dhe interesat bankare** sigurojnë një bazë të qëndrueshme financimi.
- **Rritja e të ardhurave nga ankandet** pritet të transformojë strukturën e të ardhurave në vitin 2026, duke e bërë këtë burim dominues.
- **Financimet e orientuara drejt institucioneve të drejtësisë** konfirmojnë rolin e Agjencisë si mbështetëse e reformës në drejtësi dhe si kontribuese direkte në buxhetin e shtetit.

Ky bilanc financiar dhe parashikimi për vitin 2026 e pozicionojnë AAPSK si një institucion me ndikim të rritur në administrimin e pasurive të konfiskuara dhe në mbështetjen e institucioneve shtetërore dhe OJF-ve, duke reflektuar rritje të qëndrueshme dhe orientim strategjik drejt burimeve dinamike të të ardhurave.

KUADRI GJYQËSOR

AAPSK i ka kushtuar rëndësi të veçantë mbrojtjes së interesit institucional, duke mos humbur asnjë proces gjyqësor gjatë vitit 2025—një arritje e rëndësishme që reflekton profesionalizmin dhe angazhimin e stafit.

Proceset gjyqësore të ndjekura

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar **135 procese gjyqësore**, ku palë të thirrura kanë qenë AAPSK, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe SPAK.

Çështjet kryesore që morrën vëmendje të veçantë, përfshijnë:

1. Çështja “Santa Quaranta”

Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata vendosi kalimin në pronësi të AAPSK-së (në favor të shtetit) të **13 apartamenteve dhe 1 njësie** me sipërfaqe totale **863.5 m²**. Gjithashtu, bashkëpronari u detyrua të kompensojë Agjencinë me shumën **1,100,590.61 euro**.

Në pronësi të subjektit **Balili Ko** mbetën pasuritë:

- Pasuria nr. 23/288 – truall
- Pasuria nr. 23/234 – truall
- Pasuria nr. 23/235 – truall
- Apartamentet nr. 23/287+1-10; nr. 23/287+2-43; nr. 23/287+1-46

Pas krahasimit të tre akteve të ekspertimit (A, B dhe B shtesë), alternativa e miratuar u vlerësua si më e favorshme për t’u pranuar nga AAPSK dhe gjykata. Duke llogaritur çmimet e tregut dhe mundësinë e shitjes së apartamenteve:

- **Vlera e përfitueshme me çmim tregu:** 2,026,946 euro
- **Vlera e përfitueshme me ulje 30%:** 1,418,862.2 euro
- **Kompensimi shtesë nga bashkëpronari:** 1,100,590.61 euro

Kjo strukturë përfitimi e bën vendimin optimal në raport me interesin publik dhe atë të institucionit.

2. Administratorët e larguar nga administrimi i pronave të sekuestruara

Aktet përkatëse janë administruar në gjykatë në bazë të gjetjeve të kontrolleve të kryera nga AAPSK. Është vlerësuar se veprimtaria e administratorëve të larguar nuk ka qenë në interesin më të lartë të institucionit.

Proceset gjyqësore janë në vijim, ndërsa shkeljet e konstatuara janë dokumentuar qartë dhe janë paraqitur në gjykatë.

3. Kërkesat për pagesën e vjetërsisë dhe vështirësinë në punë

Disa ish-administratorë kanë paraqitur kërkesa për kompensime financiare për periudhën nga fillimi i punës deri në vitin 2023.

Paditësja XX kërkoi:

- Diferencë page bruto: **2,746,810 lekë**
- Detyrime të papaguara (sigurime, tatime): **1,119,545 lekë**
- Kamatvonesë mbi pagën neto: **992,499 lekë**
- Interes ditor: **843 lekë** deri në ekzekutimin e vendimit

Paditësi ZZ kërkoi:

- Diferencë page neto: **4,667,442 lekë**

Vendimi i gjykatës

Në përfundim të procesit, gjykata vendosi:

- **Rrëzimin e kërkesëpadive të paditësve XX dhe ZZ**
- **Shpenzimet gjyqësore** të mbeteshin në ngarkim të paditësve

Vendimi u bazua në argumentimin ligjor të AAPSK-së dhe në korrespondencën e zhvilluar me institucionet shtetërore përkatëse. Ky vendim shmangu dëmin që agjencia rezikonte për shkak të keqinterpretimeve individuale.

4. Kthimi i pasurive të konfiskuara mbi të cilat është ekzekutuar masa e sekuestros konservative

Pasuria e paluajtshme e llojit **“Pyll”**, me nr. 183/2, zk. 2380, sipërfaqe **100,000 m²**, me adresë në Lanabregas, administrohet nga AAPSK në bazë të:

- Vendimit nr. 55, datë 20.04.2023 të Gjykatës së Apelit
- Vendimit nr. 17, datë 03.11.2022 të Gjykatës së Posaçme

Kjo pasuri ishte lënë kolateral pranë një banke të nivelit të dytë në vend, në zbatim të kontratës së overdraftit nr. 1737, datë 17.06.2020, lidhur midis bankës dhe kredimarrësit AA, me dorëzanës/hipotekues BB.

Zyra e Përmbartimit Privat ka filluar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, referuar neneve 560 dhe 563 të Kodit të Procedurës Civile duke vijuar me nxjerrjen e pasurisë së konfiskuar në ankand për tu shitur.

Referuar rastit konkret, pasuria mbi të cilën përmbauresi ka vijuar ekzekutimin është pasuri me pronar Republika e Shqipërisë dhe jo debitorin XX-ZZ, sipas kontratave të nënshkruara me Credins Bank. Pasuria për të cilën është zhvilluar ankandi është pasuri e konfiskuar me vendim të formës së prerë të gjykatës së posaçme.

Për shkak të rrezikshmërisë dhe shpejtësisë së kryerjes së veprimeve lidhur me procedurat e shitjes së pasurisë në ankand dhe pasojat e parikuperueshme që vijnë prej këtij procesi, është kërkuar dhe marrja e masës pezulluese deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.

AAPSK ka arritur të vërtetojë se përmbaruesi ka patur dijeni për për këto rrethana dhe ka vepruar me “ **keqbesim**” duke dëmtuar rëndë interesat e shtetit.

Procesi është në vijim... , dhe do të vijojë të ndiqet me përgjegjësi nga ana jonë.

EVENTE DHE HISTORI PËR T’U NDARË ME JU PËRGJATË VITIT 2025

1. Kontributi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar

Takimi i 16-të i Nënkomitetit “Drejtësia, Liria dhe Siguria” Shqipëri–Bashkimi Evropian



Gjatë vitit 2025, AAPSK ka kontribuar në mënyrë aktive përmes pjesëmarrjes në Takimin e 16-të të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria dhe Siguria” Shqipëri–Bashkimi Evropian, si dhe në forume dhe samite ndërkombëtare të nivelit të lartë mbi sigurinë, sundimin e ligjit dhe rikuperimin e aseteve Angazhim Ndërkombëtar në Luftën kundër Krimin dhe Korrupsionit

Agjencia ka qenë pjesë e delegacioneve zyrtare në Samitin për Sigurinë Kufitare në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Forumin e Katërt Ligjor BE–Partneriteti Lindor në Varshavë, duke kontribuar në shkëmbimin e praktikave më të mira për rikuperimin dhe administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, në funksion të luftës kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit.

Pjesëmarrje në Aktivitete Rajonale dhe Ndërkombëtare me Partnerë Strategjikë

AAPSK ka marrë pjesë gjithashtu në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare të organizuara nga UNODC, UNDP, OECD, SECO, BAMIN dhe GIZ, me fokus forcimin e mekanizmave të parasekuestrimit, hetimeve financiare dhe administrimit efektiv të aseteve me origjinë kriminale.

2. Marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi

Gjatë vitit raportues, AAPSK ka konsoliduar rrjetin e saj të bashkëpunimit ndërkombëtar përmes nënshkrimit të marrëveshjeve dhe memorandumëve strategjike, duke synuar forcimin e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin me standardet evropiane.

- Marrëveshje Bashkëpunimi AAPSK–UNICEF Shqipëri

Në këtë kuadër, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet **AAPSK dhe UNICEF Shqipëri**, me qëllim transformimin e pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar në hapësira funksionale në shërbim të fëmijëve, të rinjve dhe komuniteteve.

Gjithashtu, AAPSK nënshkroi Memorandume Bashkëpunimi me:

- **Agjencinë Kombëtare të Ukrainës për Gjetjen, Gjurmimin dhe Menaxhimin e Pasurive që rrjedhin nga korrupsioni dhe krime të tjera (ARMA);**
- **Agjencinë homologe të Federatës së Bosnje-Hercegovinës për Administrimin dhe Menaxhimin e Aseteve të Konfiskuara.**

Bashkëpunimi institucional u forcua edhe me **agjencitë homologe të Kosovës, Republikës Çeke, si dhe përmes kontakteve zyrtare me autoritetet zvicerane**, në funksion të ngritjes së urave të reja të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në vijim të zbatimit të strategjisë për zgjerimin dhe konsolidimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë homologe, AAPSK është në proces dhe në pritje të formalizimit të bashkëpunimit institucional me këto shtete:

- Republika Federative e Brazilit
- Mbretëria e Spanjës
- Republika Italiane
- Republika Franceze
- Republika e Kosovës



Nderkohe sa i përket bashkëpunimeve institucionale brenda vendit kemi finalizuar :

- Marreveshjen me Policine Bashkiake Tiranë
- Marreveshja me DPPSH
- Marreveshje me Rezervat e Shtetit

3. Administrimi dhe ripërdorimi social i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara

Një nga prioritetet kryesore të AAPSK gjatë vitit 2025 ka qenë rritja e transparencës dhe maksimizimi i vlerës sociale të pasurive të konfiskuara.

Në këtë kuadër, për herë të parë u realizua publikimi online i katër katalogëve të pasurive (pasuri të konfiskuara, pasuri të sekuestruara, prova materiale dhe mjete), duke rritur ndjeshëm aksesin publik dhe transparencën institucionale.



AAPSK shpalli dhe finalizoi thirrjen publike për projekt-ide për ripërdorimin social të pasurive të konfiskuara, **me 30 aplikime të paraqitura**. Aktualisht, **tre projekte janë në fazën përfundimtare të përgatitjes** dhe parashikohet të nisin zbatimin në tremujorin e parë të vitit 2026.

Gjatë vitit u zhvilluan dhe u përmbyllën disa iniciativa të rëndësishme, ndër to:

- U finalizua Projekti “Toka Jonë”, si model novator i ripërdorimit social të tokave të konfiskuara;
- U nënshkrua Projekti “PUBLIK”, që shndërron një pasuri të konfiskuar në galeri arti, qendër komunitare dhe hapësirë edukimi artistik dhe teknologjik;
- U nënshkrua kontrata me organizatën “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”, për vënien në përdorim të një objekti të konfiskuar për rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit.

4. Mbështetje për institucionet publike dhe shërbimet sociale

AAPSK ka vijuar të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të institucioneve publike dhe shërbimeve sociale përmes dhënies në përdorim dhe transferimit pa pagesë të pasurive të konfiskuara.

Gjatë vitit 2025:

- U vunë në dispozicion automjete për Bashkinë Bulqizë dhe Shtëpinë e Fëmijës në Bashkinë Shkodër;
- U mbështet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me 15 autoambulanca të reja të kategorisë A, për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe logjistike;
- U vijua shpërndarja e ndihmave materiale për institucionet e kujdesit social, përfshirë veshje, pajisje elektronike dhe produkte të konfiskuara
- AAPSK është angazhuar për krijimin e një strategjie mbi edukimin mjedisor, e cila filloi me aktivitetin e pare edukues së bashku me nxënësit e shkollave pranë Qendrës së Trajtimit të Mbetjeve të sekuestruar në Sharrë, Tiranë, me fokus njohjen me parimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

5. Rritja e kapaciteteve institucionale dhe profesionale

Në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit, AAPSK organizoi dhe mori pjesë në një sërë trajnimesh të specializuara, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.

Trajnimet u fokusuan në:

- Menaxhimin e llogarive bankare të sekuestruara dhe të konfiskuara (EU4LEA, EU4FAST);
- Administrimin e kriptovalutave dhe aseteve virtuale në kuadër të sekuestrimit dhe konfiskimit (EU4LAW ENFORCEMENT);
- Zbatimin e Ligjit nr. 9901 dhe mënyra e administrimit të shoqërive tregtare;
- Në bashkëpunim me UNICEF Shqipëri u kryen 2 sesione trajnimi :
 1. Cfare janë Kriptomonedhat dhe sistemi Blockchain
 2. Modele inovative të menaxhimit te Kriptomonedhave me fokus suportin ndaj fëmijëve ne nevojë
- Në bashkëpunim me GIZ:

1. Kriptomonedhat dhe mënyra e investigimit të lëvizjeve digjitale
2. Maredhenia me Bankat dhe menaxhimi i llogarive

6. Politikat e sigurisë dhe lufta kundër krimit të organizuar

AAPSK ka marrë pjesë aktive në takime ndërinstitucionale dhe rajonale mbi politikën kundër drogës, krimin e organizuar, krimin kibernetik dhe përdorimin e kriptovalutave për qëllime kriminale, duke kontribuar në forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë.

Në përfundim, gjatë vitit 2025 AAPSK ka forcuar ndjeshëm rolin e saj institucional në administrimin efektiv, transparent dhe me impakt social të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, duke u pozicionuar si një aktor kyç në luftën kundër krimit të organizuar dhe në përmbushjen e standardeve evropiane në këtë fushë.

PËRMBLEDHJE AKTIVITETESH

Në këtë vit intensiv të punës dhe përkushtimit të institucionit, gjeni të përmbledhura aktivitetet që i dhanë identitet dhe forcim të pozitive institucionale Agjencisë, duke krijuar ura të reja lidhëse dhe bashkëpunimi.

29 dhjetor 2025

Kthimi i pasurive të konfiskuara nga krimi në mundësi për të ardhmen e viktimave të dhunës dhe trafikimit mbetet një prioritet i yni



Ministrja e Punëve të Brendshme Albana Koçiu, së bashku me ekipin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, vizituan një nga shembujt më domethënës të kësaj nisme: një objekt i përfituar nga veprimtari kriminale, i cili sot shërben si një strehë e sigurt për viktimat

Deri në vitin 2025, kemi realizuar mbi 15 projekte të kësaj natyre, kemi mbështetur më shumë se 20 institucione dhe kemi ndihmuar drejtpërdrejt rreth 300 viktima të dhunës dhe trafikimit

26 dhjetor 2026

Deri në muajin nëntor 2025, të ardhurat tregojnë një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2024.

Këto rezultate pasqyrojnë punën e vazhdueshme, menaxhimin e përgjegjshëm dhe angazhimin institucional në arritjen e objektivave.

Vijojmë me përkushtim drejt rezultateve edhe më të mira.



22 dhjetor 2025

Fundi i vitit 2025 shënon një tjetër hap përpara për AAPSK.

Administrim efikas i pasurive, bashkëpunime ndërkombëtare, projekte sociale dhe ripërdorim në shërbim të komunitetit.

Me transparencë dhe profesionalizëm, vijojmë misionin tonë.



Mesazh nga Kryeadministratorja | Fundi i vitit 2025

Teksa përmbyllim vitin 2025, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) paraqitet më e konsoliduar, më transparente dhe më e lidhur së kurrë me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë.

Gjatë këtij viti, kemi zgjeruar bashkëpunimin ndërkombëtar, kemi forcuar kapacitetet institucionale dhe kemi avancuar ndjeshëm ripërdorimin social të pasurive të konfiskuara, duke i kthyer ato në përfitime konkrete për komunitetet, institucionet publike dhe grupet në nevojë. Publikimi i katalogëve të pasurive, rritja e partneriteteve, si dhe rritja e të ardhurave dhe e impaktit social, dëshmojnë angazhimin tonë për transparencë, llogaridhënie dhe qasje inovative.

Viti 2025 ka riasfrimuar bindjen tonë se administrimi efektiv i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një instrument strategjik në shërbim të drejtësisë, vlerës sociale dhe besimit publik.

Të udhëhequr nga standardet evropiane dhe të mbështetur në profesionalizmin e stafit tonë, AAPSK vijon të ndërtojë një institucion modern dhe të qëndrueshëm, me transparencë, integritet dhe interesin publik në qendër të misionit të tij.

Me respekt,
Risena Xhaja
Kryeadministratorë
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara

“ AAPSK mbetet e angazhuar në përbushjen e misionit të saj ligjor për administrimin dhe ripërdorimin efikas të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, në dobi të komunitetit dhe shtetit të së drejtës.

Me transparencë, profesionalizëm dhe përkushtim, vijojmë të ndërtojmë modele të suksesshme që rikthejnë pasuritë e krimit në shërbim të komunitetit.

”



Na Kontaktoni:

Phone
+042254071

Email
info@aapsk.gov.al

Address
Kompleksi Delijorgji, Tiranë

Website
aapsk.gov.al



AAPSK
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara



Të ardhura nga veprimtaria e AAPSK-së

Të ardhurat e realizuara nga interesat bankare arritën në total 1,300, 000 Euro për vitin 2025. Krahasuar me vitin 2024, ku totali ishte 650,000 Euro, Agjencia realizoi në masën 48.5% të ardhura nga interesat, më tepër se viti i parardhës.

Për vitin 2025 AAPSK ka realizuar:

- 3 milion euro të ardhura (vetëm nga qiraja e pasurive) asnjë shitje;
- 12.2 milion euro ka financuar buxhetin e shtetit dhe projekte të institucioneve të heimit;
- 4 pasuri të paluajtshme i kanë kaluar në pronësi institucioneve shtetërore;
- 2 pasuri për ripërdorim social;
- 26 automjete kanë kaluar në pronësi të institucioneve
- 6 automjete në përdorim



Bashkëpunimi Ndërkombëtar

- Pjesëmarrje aktive në takime dhe forume të nivelit të lartë me BE-në dhe partnerë strategjikë
- Përfaqësim në Samitin për Sigurinë Kufitare në Mbretërinë e Bashkuar dhe Forumin Ligjor BE-Partneriteti Lindor (Varshavë)
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me organizata ndërkombëtare si UNODC, UNDP, OECD, SECO, BAMIN dhe GIZ
- Kontribut në shkëmbimin e praktikave me të mira për rikuperimin dhe administrimin e aseteve kriminale




Administrimi dhe Ripërdorimi Social i Pasurive






Statistika mbi inventarin e pasurive në administrim të AAPSK



Deri më 30.10.2025, AAPSK administron 2,757 pasuri/prova materiale, të ndara si më poshtë:

- 1,615 pasuri të sekuestruara
- 459 pasuri të konfiskuara
- 643 prova materiale
- 40 llogari bankare dhe shuma monetare të konfiskuara



Pasuritë në administrim përfshijnë:

- Pasuri të paluajtshme (apartamente, objekte, toka, pyje dhe kullota);
- Pasuri të luajtshme (automjete dhe mjete motorike);
- Subjekte tregtare dhe asete financiare;
- prova materiale të lidhura me procedimet penale.

Gjatë periudhës janar-tetor 2025, janë shtuar 1,028 pasuri/prova materiale të reja në administrimin e AAPSK-së, duke reflektuar një rritje të vazhdueshme të volumit të punës dhe përgjegjësiwe institucionale.

18 dhjetor 2025

Kryeadministratorja, znj. Risena Xhaja, zhvilloi një takim me përfaqësueset të UNDP Albania, znj. Randi Davis, Resident Representative, dhe znj. Entela Lako, Programme Officer.

Takimi u përqendrua në forcimin e bashkëpunimit për zbatimin e projekteve me pushtetin vendor, me theks të veçantë në ripërdorimin social të pasurive, si dhe në vlerësimin e mundësive konkrete


për thellimin e bashkëpunimit institucional dhe hedhjen e hapave drejt një marrëveshjeje dypalëshe.

Një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të partneriteteve të qëndrueshme dhe rritjes së ndikimit social pozitiv.



17 dhjetor 2025

Kryeadministratorja Znj. Risena Xhaja mori pjesë sot në konsultimin e organizuar nga UNICEF, ku u reflektuan rezultatet e vitit 2025 dhe u prezantuan prioritetet strategjike për 2026.



Gjatë fjalës së saj, ajo theksoi rolin dhe kontributin e AAPSK në forcimin e sistemeve dhe bashkëpunimin institucional.

Diskutimet u fokusuan gjithashtu në drejtimet kryesore të Programit të ri të Vendit 2027–2031, në përputhje me Planin e ri Strategjik të UNICEF dhe procesin e integritit evropian. Përpara me angazhim dhe partneritet drejt rezultateve më të mira për fëmijët dhe familjet.

15 dhjetor 2025

Kryeadministratorja e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), znj. Risena Xhaja, mbajti sot fjalën përshëndetëse në Konferencën Vjetore të organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile.



Në fjalën e saj, znj. Xhaja theksoi se viti 2025 ka qenë një vit me zhvillime pozitive për AAPSK, duke u shoqëruar me rritje të transparencës, përmirësim të procedurave dhe forcim të standardeve të llogaridhënies në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.



Një vëmendje e veçantë ju kushtua ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar, të cilin Kryeadministratorja e cilësoi si një instrument të drejtpërdrejtë për kthimin e pasurive të paligjshme në vlerë për shoqërinë. Sipas saj, ky proces nuk përbën vetëm një mekanizëm administrativ, por një politikë me ndikim të qartë social, që kontribuon në forcimin e kohezionit social, rritjen e solidaritetit dhe mbështetjen e komuniteteve në nevojë.

“Ripërdorimi social i pasurive është mënyra se si shteti i përgjigjet padrejtësive dhe pabarazive, duke i kthyer pasuritë e krimit në shërbim të interesit publik,” u shpreh znj. Xhaja, duke nënvizuar se kjo qasje ka ndikuar pozitivisht edhe në perceptimin publik ndaj AAPSK, si një institucion me rol aktiv në shërbim të shoqërisë.

Kryeadministratorja theksoi gjithashtu afrimin e agjencisë me komunitetet dhe organizatat e shoqërisë civile, duke e konsideruar komunikimin, transparencën dhe hapjen ndaj publikut si elementë kyç për ndërtimin e besimit dhe rritjen e efektivitetit institucional.

Duke folur për perspektivën e vitit 2026, znj. Xhaja bëri të ditur se AAPSK synon të forcojë më tej ndikimin social të pasurive të rikthyera në përdorim publik, të thellojë standardet e transparencës dhe të zgjerojë bashkëpunimin me aktorët që veprojnë në terren për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përfshirjen sociale.

Konferenca Vjetore e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi shërbeu si një platformë dialogu dhe reflektimi mbi veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2025 dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe me shoqërinë civile në luftën kundër diskriminimit.

11 dhjetor 2025

Pjesëmarrja në Takimin Rajonal në Budva



Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara mori pjesë në takimin rajonal të zhvilluar në Budva, i fokusuar në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e sekuestrimit, konfiskimit dhe administrimit të pasurive.

Gjatë takimit u trajtuan çështje kyçe:

- shkëmbimi i praktikave më të mira ndërmjet vendeve të rajonit;
- përditësimi mbi statistikatat dhe sfidat në administrimin e pasurive të konfiskuara;
- koordinimi institucional në proceset e rikuperimit të pasurive;
- zhvillimet ligjore dhe strategjike që ndikojnë në rritjen e transparencës dhe efikasitetit.

Pjesëmarrja e AAPSK në këtë aktivitet përbën një mundësi të rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe përmirësimin e standardeve të administrimit të pasurive.

4 dhjetor 2025

Takimi ndërinstytucional për forcimin e politikave kundër drogës

AAPSK mori pjesë në takimin ndërinstytucional të dedikuar forcimit të politikave kombëtare kundër drogës.



Shqipëria ka bërë përparime të dukshme në këtë fushë, përfshirë:

- krijimin e Observatorit Kombëtar të Drogave;
- rritjen e bashkëpunimit me partnerët e Bashkimit Evropian;
- forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe parandalimit.

AAPSK kontribuo në diskutimet mbi rolin e saj në përmirësimin e reagimit kombëtar ndaj sfidave të drogave, duke theksuar rëndësinë e administrimit të pasurive të sekuestruara si instrument kundër krimit të organizuar.

1 dhjetor 2025

Aktiviteti edukues “Brezat e rinj për menaxhimin e mbetjeve”



Në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve në Tiranë u zhvillua aktiviteti edukues “Brezat e rinj për menaxhimin e mbetjeve”, një nismë e përbashkët e:

- Ministrisë së Mjedisit,
- AAPSK,
- Universitetit Polis,
- shkollës 9-vjeçare “Sharre”.

Qëllimi i aktivitetit

Rritja e ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe të rinjve mbi:

- ndarjen e mbetjeve në burim,
- riciklimin,
- reduktimin e ndotjes,
- përgjegjshmërinë mjedisore në komunitet.

Deklaratat institucionale

Ministri i Mjedisit, z. Sofjan Jaupaj, theksoi rëndësinë e menaxhimit të integruar të mbetjeve si pjesë e reformave mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kryeadministratorja e AAPSK, znj. Risen Xhaja, prezantoi rolin e Agjencisë në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, duke nënvizuar:

“Pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara janë një mundësi e çmuar për t’i kthyer komunitetit atë që i është marrë përmes veprimtarisë së paligjshme. Qëllimi ynë është t’i administrojmë me transparencë dhe përgjegjësi, në mënyrë që çdo aset të kthehet në dobi, vlerë dhe shërbim publik.”

Aktivitetet praktike

- prezantimi i proceseve të trajtimit të mbetjeve;
- diskutime të hapura me nxënës dhe studentë;
- shpërndarja e trastave shumëpërdorimëshe dhe koshave për ndarjen e mbetjeve në burim;
- vizitë në terren në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve.

Ky aktivitet u vlerësua si një model bashkëpunimi ndërinstitutional dhe edukimi mjedisor.

26 nëntor 2025

Zgjerimi i projekteve të ripërdorimit social

AAPSK ka zgjeruar më tej projektet e ripërdorimit social të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, duke i kthyer ato në shërbim të komunitetit dhe grupeve vulnerabël.



Ripërdorimi Social i Pasurive të Konfiskuara – Partneriteti me “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

Së fundmi, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka nënshkruar një kontratë të re huapërdorjeje me organizatën **“Të Ndryshëm & Të Barabartë”**, për vënien në dispozicion të një objekti të konfiskuar, me destinacion ofrimin e shërbimeve sociale.

Sipas kontratës, objekti do të përdoret për **rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit**, një nga kauzat më të rëndësishme të organizatës, në përputhje me **Vendimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar**, datë 06.11.2025, për kalimin pa pagesë të kësaj pasurie në përdorim social.

Ky partneritet përfaqëson një hap të rëndësishëm në vizionin e AAPSK për **ripërdorimin social të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara**, duke e shndërruar këtë mekanizëm në një instrument konkret mbështetjeje për:

- viktimat e trafikimit,
- individët dhe grupet vulnerabël,
- projektet sociale dhe komunitare,
- programet e rehabilitimit dhe riintegrit.

Nën drejtimin e Kryeadministratores **Risena Xhaja**, AAPSK po zgjeron ndjeshëm bashkëpunimet me organizata vendase dhe ndërkombëtare, si pjesë e një programi të gjerë të orientuar drejt:

- rritjes së transparencës në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara,
- rritjes së efektivitetit të ripërdorimit social,
- krijimit të mundësive reale për shërbime komunitare dhe sociale,
- forcimit të politikave të parandalimit të krimit të organizuar përmes rikthimit të pasurive në funksion publik.

Kontrata e nënshkruar me **“Të Ndryshëm & Të Barabartë”** është një shembull i qartë i kësaj qasjeje: **një objekt që dikur ka qenë pjesë e aktivitetit kriminal, sot shndërrohet në një hapësirë që ofron strehim, kujdes dhe mbështetje për njerëzit në nevojë.**

Projekti pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në:

- forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes sociale,
- integrimin e viktimave të trafikimit në shoqëri,
- rritjen e infrastrukturës së qendrave të specializuara,
- ofrimin e mbështetjes psikologjike, sociale dhe profesionale,

- zbatimin e angazhimeve të Shqipërisë në fushën e të drejtave të njeriut dhe luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Në kontratë përcaktohet qartë se **destinacioni i objektit është ekskluzivisht rehabilitimi dhe riintegrimi**, dhe nuk mund të ndryshohet pa miratimin paraprak të AAPSK, duke garantuar ruajtjen e qëllimit të tij social.

Ky partneritet vjen në kuadër të nismave të shumta të ndërmarra nga AAPSK gjatë vitit 2025, në bashkëpunim me:

- organizata të shoqërisë civile,
- institucione shtetërore,
- programe sociale dhe edukative,
- projekte komunitare me impakt të lartë.

Ky model i ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara përputhet me **praktikat më të mira evropiane**, duke i kthyer asetet e krimit të organizuar në instrumente për:

- zhvillim social,
- integrim,
- mbrojtje të grupeve vulnerabël,
- forcim të shtetit të së drejtës.

21 Nëntor, 2025

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) mirëpriti në një takim zyrtar përfaqësuesit e Ambasadës Franceze, z. Thierry Baures, z. Cyril Lacombe dhe z. Eric Martinville.



Gjatë takimit u diskutua mbi ide të reja dhe mundësi bashkëpunimi në fushën e menaxhimit dhe rikuperimit të aseteve, si dhe u shqyrtuan hapat e mundshëm për forcimin e kapaciteteve institucionale të AAPSK-së.

Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një partneriteti të qëndrueshëm dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta, me synim adoptimin e praktikave moderne dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

AAPSK mbetet e angazhuar për të vijuar me vizion, profesionalizëm dhe energji në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të saj dhe promovimin e transparencës në administrimin e pasurive.

20 Nëntor, 2025

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit të

saj, organizoi sot një trajnim të specializuar me temë “Shoqëritë tregtare dhe QKB”. Aktiviteti u zhvillua në ambientet e GIZ në Tiranë, në bashkëpunim me GIZ dhe PKF Albania.



Ligjërimi u mbajt nga z. Julian Saraçi, Auditues Ligjor dhe Konsulent i Pavarur, i cili përmes një sesiioni të strukturuar mbi bazën e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për sipërmarrjen dhe shoqëritë”, trajtoi çështje kyçe që lidhen me themelimin, regjistrimin, qeverisjen dhe administrimin e shoqërive tregtare — me fokus të veçantë mbi rastet e shoqërive të vendosura nën sekuestro apo konfiskim.

Trajnimi synoi rritjen e njohurive dhe aftësive praktike të stafit të AAPSK, duke u bazuar në ligjërime interaktive, analizë rastesh dhe diskutime mbi situata konkrete të hasura gjatë administrimit të subjekteve tregtare.

Gjatë sesiionit, pjesëmarrësit u njohën me:

- * kuadrin ligjor dhe konceptet bazë të Ligjit 9901, përfshirë strukturën dhe format e shoqërive tregtare;
- * procedurat e themelimit dhe regjistrimit të shoqërive në QKB, dokumentacionin përkatës dhe hartimin e statutit;
- * qeverisjen korporative dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese, me theks të roli i administratorëve dhe mënyrat e përfaqësimit ligjor;
- * të drejtat dhe detyrimet e aksionarëve, mekanizmat e vendimmarrjes dhe menaxhimin e konflikteve të interesit;

* interpretimin e rregullave ligjore në administrimin e shoqërive të sekuestruara apo të konfiskuara, një proces me rëndësi të veçantë për misionin e AAPSK.

Programi përfshiu katër sesione tematike, të shoqëruara me diskutime mbi praktikën e mira dhe sfidat në zbatim, ndërsa aktiviteti u mbyll me një sesion përmbledhës dhe shkëmbim komentesh nga pjesëmarrësit.

Pjesë në trajnim morën përfaqësues nga institucionet: AAPSK, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokuroria e Përgjithshme, GjKKO, Drejtoria e Tatimeve, ASP dhe Zyra e Rikuperimit të Aseteve.

Nëpërmjet këtij trajnimi, AAPSK vijon përpjekjet për forcimin e profesionalizmit, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e procesit të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, në funksion të një menaxhimi më efikas të tyre.

18 Nëntor, 2025

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) merr pjesë në workshop-in tre-ditor “Inspektorëve Tatimorë pa Kufij – Programi i Hetimeve Penale”, organizuar në Tiranë nga UNDP, OECD dhe qeveria zvicerane (SECO), me pjesëmarrjen e institucioneve kyçe ligjzbatuese të vendit dhe partnerëve ndërkombëtarë.





Ky aktivitet, i cili zhvillohet nga data 17 deri në 19 nëntor 2025, synon forcimin e kapaciteteve të institucioneve shqiptare në luftën kundër krimeve financiare, evazionit fiskal dhe pastrimit të parave, si dhe rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional për administrimin efektiv të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Gjatë sesionit të dedikuar për prezantimin e mandateve institucionale, Kryeadministratorja e AAPSK-së, znj. Risena Xhaja, prezantoi funksionet, sfidat dhe rezultatet e Agjencisë në administrimin e pasurive që burojnë nga aktivitete të paligjshme.

Znj. Xhaja theksoi se AAPSK është hallkë e rëndësishme në zinxhirin e drejtësisë, duke siguruar ruajtjen, menaxhimin, vlerësimin dhe rikthimin në ekonomi të pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara, si një instrument kyç për goditjen e krimit të organizuar dhe ekonomisë ilegale.

Ajo prezantoi një panoramë të qartë të kategorive të pasurive që administron Agjencia, si dhe vëllimin e konsiderueshëm të aseteve nën administrim, të cilat variojnë nga pasuri të paluajtshme dhe mjete transporti, deri te llogari bankare, biznese, sende me vlerë dhe materiale të tjera.

Gjatë fjalës së saj, Kryeadministratorja vuri në dukje disa sfida që kërkojnë adresim të përbashkët ndër-institucional, që kanë të bëjnë me vlerësimin dhe mirëmbajtjen e pasurive, kompleksiteti ligjor dhe procedural në administrimin e tyre, sfidat financiare dhe operacionale që kanë të bëjnë me kostot e mirëmbajtjes, proceset e likuidimit, digjitalizimin dhe burimet njerëzore, si edhe nevojën për më shumë transparencë.

Ajo theksoi se përballja me këto sfida kërkon një qasje të integruar dhe rritje të bashkëpunimit ndër-institucional.

Znj. Xhaja ndau gjithashtu disa nga rezultatet e arritura në vitin e saj të parë në krye të AAPSK, që kanë të bëjnë me përmirësimin e administrimit të shumë kategorive të pasurive nëpërmjet procedurave më transparente; rritjen e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese dhe partnerët ndërkombëtarë; përgatitjen e modeleve të reja të raportimit publik dhe standardeve

më të mira të menaxhimit të aseteve; si edhe zgjerimin e projekteve për përdorimin social të pasurive, në funksion të interesit publik.

Në përfundim të fjalës së saj, Kryeadministratorja nënvizoi vizionin e Agjencisë për t'i kthyer pasuritë e konfiskuara në “dobi për shoqërinë”, duke theksuar se administrimi i tyre i drejtë dhe transparent është një formë konkrete drejtësie sociale.

Gjatë tre ditëve të workshopit, përfaqësues të AAPSK, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Policisë së Shtetit, SPAK, Prokurorisë, AIF, Doganave, si dhe partnerëve ndërkombëtarë (OECD, UNDP, SECO, Guardia di Finanza, EU4LEA) do të trajtojnë modelet e maturimit institucional, bashkëpunimin ndërinstitucional, zhvillimin e strategjive kundër krimit financiar dhe përmirësimin e mekanizmave të hetimit dhe sekuestrimit të pasurive.

Në fund të workshopit do të prezantohen edhe vlerësimet dhe rekomandimet për forcimin e kapaciteteve kombëtare, të cilat do të shërbejnë si bazë për Fazën II të programit TIWB–CI.

5 Nëntor 2025

Në vijim të forcimit të kapaciteteve të AAPSK



Në vazhden e trajnimeve të planifikuara për të përmirësuar njohuritë e stafit të AAPSK, me mbështetjen e projekteve EU4LEA dhe EU4FAST, zhvilluam në Tiranë një trajnim mbi menaxhimin e llogarive bankare të sekuestruara dhe të konfiskuara,. Në këtë trajnim morën pjesë dhe kolegë nga Zyra e Rekuperimit të Aseteve si dhe kolegë nga Agjencia e Administrimit të Aseteve të Bosnje Hercegovinës.

4 Nëntor 2025

AAPSK nënshkruan memorandum bashkëpunimi me agjencinë homologe të Bosnje-Hercegovinës



Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, e përfaqësuar nga Kryeadministratozja znj. Risena Xhaja, nënshkroi në Tiranë Memorandumin e Partneritetit dhe Bashkëpunimit me Agjencinë për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara të Federatës së Bosnjë-Hercegovinës (FAZUOI), të përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv z. Emir Bašić.

Ky memorandum shënon një hap të ri në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, për administrimin dhe përdorimin social të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Znj. Risena Xhaja:

“Kjo marrëveshje konsolidon rolin e Shqipërisë si një partner i besueshëm në rrjetin evropian të institucioneve që luftojnë krimin e organizuar, përmes administrimit transparent dhe me përgjegjësi të pasurive.”

Ky bashkëpunim hap rrugën për projekte të përbashkëta, shkëmbim përvojash dhe trajnime, në përputhje me standardet më të mira evropiane.

3 Nëntor 2025

Të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të sekuestruara arrijnë 162.2 mln lekë, rritje me 48% në 2025

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) raportoi rritje të ndjeshme të të ardhurave nga qiradhënia në 9-mujorin e parë të vitit 2025.

Sipas të dhënave zyrtare, të ardhurat nga qiratë arritën në 162.2 milionë lekë, nga 109.5 milionë lekë në të njëjtën periudhë të një viti më parë, me një rritje prej 48.2%.

Në këtë periudhë nuk janë zhvilluar procedura shitjeje pasurish të sekuestruara apo të konfiskuara, ndaj e gjithë rritja ka ardhur nga menaxhimi dhe dhënia me qira e tyre.

Agjencia thekson se është përmirësuar procesi i administrimit dhe bashkërendimi me institucionet e tjera shtetërore dhe pushtetin vendor për përdorimin më efikas të pasurive në administrim.

Muaji shtator ka rezultuar me të ardhurat më të larta për Agjencinë, të cilat arritën në 22.4 milionë lekë, nga 15 milionë lekë në të njëjtin muaj të vitit të kaluar — një rritje prej afro 49%.


Rritja tregon se strategjitë e reja për vënien në përdorim të pasurive po japin efekt të menjëhershëm, me gjithnjë e më shumë prona që gjenerojnë të ardhura të qëndrueshme për buxhetin e agjencisë, përmes të cilit mbështeten edhe institucionet ligjzbatuese.

Në raport me vitin 2024, të ardhurat janë rritur me rreth 53 milionë lekë, duke reflektuar një ecuri më të mirë pothuajse çdo muaj, sidomos gjatë marsit, korrikut dhe shtatorit — periudha kur janë formalizuar më shumë kontrata të reja qiraje.

Nëse ky trend vazhdon, të ardhurat totale për vitin 2025 pritet të kalojnë kufirin prej 200 milionë lekësh, duke shënuar nivelin më të lartë që prej krijimit të agjencisë.

AAPSK, përveç rritjes së të ardhurave, ka si prioritet përdorimin social të pasurive të konfiskuara, përmes projekteve në bashkëpunim me bashkitë dhe organizatat sociale, si pjesë e politikës për rikthimin e vlerës së pasurive në shërbim të komunitetit.

“Rritja e të ardhurave nuk është vetëm tregues financiar, por edhe dëshmi e një administrimi më të drejtë dhe më transparent të pasurive që i kthehen shoqërisë,” bën me dije AAPSK.



28 Tetor 2025

Sot zhvilluam një takim me përfaqësues të World Vision Albania, një organizatë me përvojë të gjatë në mbështetjen dhe fuqizimin e fëmijëve, të rinjve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë.



Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin mes Agjencisë dhe World Vision në kuadër të ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara.

Mbrojtja dhe përfshirja sociale, aktivizmi rinor, aftësitë për jetën dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik për familjet në nevojë janë vlera të përbashkëta që na udhëheqin drejt një impakti më të gjerë social.

27 Tetor 2025

AAPSK mbështet qendrat sociale në Kamëz, Vlorë, Elbasan dhe Shkodër me materiale të konfiskuara.

Ajo që dikur ishte fryt i padrejtësisë, sot shndërrohet në mundësi për shpresë, dinjitet dhe një fillim të ri për ata që po përballen me sfida të vështira. Ky është qëllimi që prej kohësh udhëheq bashkëpunimin mes Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.



Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, së bashku me Kryeadministratoren e AAPSK, znj. Risen Xhaja, vizituam disa institucione të përkujdesit shoqëror që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit – dhe jo vetëm. Në aktivitetet e mbajtura në Tiranë, Elbasan, Vlorë e Shkodër, një sërë pasurish të sekuestruara iu shpërndanë grave, vajzave e djemve që marrin shërbim në këto qendra.

Kjo nismë është pjesë e politikës së përdorimit social të pasurive të konfiskuara, në përputhje me praktikat europiane që synojnë kthimin e pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme në

shërbim të komunitetit, dhe realizohet në zbatim të vendimit të Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar.


Ky është vetëm fillimi i një bashkëpunimi afatgjatë drejt ripërdorimit social të të gjithë pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara. Ne jemi të angazhuar që kjo nismë të zgjerohet në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror, me mbështetje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme në përputhje me nevojat e përfutjesve.

5 Tetor, 2025

Pas Shkodrës dhe Laçit, ka nisur puna për lirimin e një tjetër hapësire publike, në Vlorë. Hapësira të tilla, të përdorura prej vitesh si pika grumbullimi për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara, po kthehen një e nga një në shërbim të qytetarëve.

Ministrja e Punëve të Brendshme Albana Koçi ishte së bashku me Ministrin e Mbrojtjes Pirro Vengu, Kryeinspektoren e AAPSK-së Risena Xhaja, nënkryetarin e Bashkisë Vlorë dhe drejtorin vendor të Policisë në një inspektim në Vlorë.

“Jemi në zonën e Nartës, është një nga 24 pikat e bllokimit në të gjithë vendin që Policia e Shtetit përdor për të gjithë automjetet e konfiskuara dhe të sekuestruara. Në fakt, që prej fillimit të muajit shtator, së bashku me AAPSK, kemi nisur një fushatë mbarëkombëtare për të pastruar të gjitha këto pika, të cilat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme në të gjithë territorin e vendit, për t’i sistemuar, për të seleksionuar të gjitha ato mjete, që aktualisht kanë prej vitesh të depozituara. Siç mund ta shikoni, janë plotësisht jashtë funksionit”, u shpreh Koçi.



Proces po zbatohet në të gjithë vendin, në bashkëpunim mes Policisë së Shtetit, AAPSK-së, Drejtorisë së Rezervave Materiale të Shtetit, bashkive dhe institucioneve të tjera, me qëllim lirimin e hapësirave të bllokuara, pastrimin e mjedisit dhe rikthimin e tyre për përdorim publik.

“Agjencia, gjatë këtij muaji ka bërë një punë të lavdërueshme duke seleksionuar dhe evidentuar të gjitha mjetet, që ndodhen në këto pika, e janë për skrap apo për prova materiale, dhe janë të detyrueshme për t’u mbajtur nga Policia e Shtetit, si dhe të gjitha ato mjete që mund të jenë për përdorim e të cilat përmjet një plani që Agjencia ka hartuar, do t’i shpërndahen institucioneve publike për t’u përdorur prej tyre”, nënvizoi drejtuesja e MPB-së.

Pikat e bllokimit të përdorura nga Policia e Shtetit janë sipërfaqe të konsiderueshme që shpesh herë krijojnë edhe problematika për komunitetet duke u kthyer edhe në zona të pasigurta.

“Në vijim të këtij aksioni të pastrimit të sipërfaqeve, ajo që jemi duke bërë është t’i shndërrojmë këto zona, në zona jo vetëm të pastra, por edhe në zona që fare mirë mund t’i përdorë pushteti vendor për të hartuar plane zhvillimi e për t’i kthyer komuniteteve në zona, kënde lojërash apo argëtimi për fëmijët por edhe për t’u përdorur nga institucionet publike, për qëllime apo interes publik”, tha Koçi.

Kryeinspektorja Xhaja informoi se qarku i Vlorës ka 8 pika grumbullimi të mjeteve.

“Kjo është pika e përqendruar, më e madhe. 5 pika janë në Sarandë, 1 në Delvinë, 1 në Himarë dhe kjo është në Vlorë dhe është një ndër pikat më të mëdha në rang vendi. Nga evidentimi që ka bërë DVP Vlorë, janë 2,124 mjete e motomjete, të sekuestruara e të konfiskuara, njëkohësisht edhe prova materiale, nga të cilat 1,400 shkojnë për skrap, pra lirohet pothuaj 80% e sipërfaqes. Pjesa tjetër janë të konfiskuara e do vlerësohet për t’iu kaluar institucioneve dhe ato që janë prova materiale, jemi në kontakt me Prokurorinë e Përgjithshme, të mbyllen si çështje dhe t’u japim një drejtim edhe atyre”, theksoi Xhaja.

“Është shumë e rëndësishme sidomos për një pikë si kjo në Nartë, shumë pranë komunitetit të banorëve dhe shumë pranë zonave turistike dhe pranë një aksi transporti që do të rehabilitohet dhe ka të bëjë me projektin e hekurudhës së re dhe ndërlidhjes së Vlorës me aeroportin. Duke pastruar zonën nga kjo situatë e ngarkuar prej disa dekadash, ne fillojmë rehabilitimin, duke biseduar edhe me kryetarin, nevoja ishte emergjente që për një pjesë, bashkia të mund ta rikuperonte hapësirën dhe sipërfaqen në zonat e banuara. Nga ana tjetër të fillonte një përdorim normal duke ditur që siguria patjetër që cenohet në këto zona, edhe mjedisi, pa dyshim, sepse kemi të bëjmë me materiale që rrinë e degradohen, sidomos me një zonë të pyllëzuar siç është këtu.

Do të kemi një periudhë disamujore ku mund të fillojmë evadimin progresiv, besoj se keni një plan se si do të ecë kjo”, pohoi Ministri Vengu.

Rreth 5 muaj është përlogaritur procesi i largimit të mjeteve.

“Duhet thënë që brenda një muaji, AAPSK ka filluar me seleksionimin e të gjitha mjeteve që ndodhen në të tilla pika grumbullimi, e ndihmuar fort edhe nga Policia e Shtetit, pasi vetë policia

është duke bërë një vlerësim në këtë pikë dhe është një bashkëpunim ndërinstituconal, pra janë një sërë strukturash të përfshira, përveç Agjencisë, Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit. Pra jemi së bashku në këtë proces që është i rëndësishëm për t'i kthyer territoret në sipërfaqe publike, të aksesueshme, të përdorshme nga komunitetet, qeverisja vendore, nga të gjithë sëbashku, për zona më të sigurta, për vende më të pastra, më miqësore”, e mbylli mesazhin e saj Ministria e Punëve të Brendshme.

1 Tetor, 2025

Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, znj. Risenaxhaja, mori pjesë në Konferencën Rajonale “Resilient Voices: Civil Society in a Changing Western Balkans”, e cila u zhvillua në Tiranë dhe mbledhi aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile, institucioneve publike dhe partnerëve ndërkombëtarë.



Znj. Xhaja ishte pjesë e panelit “Funding Futures – Navigating Donor Shifts and Building Sustainability”, ku diskutoi mbi inovacionet dhe modelet alternative për zhvillueshmëri të qëndrueshme përmes ripërdorimit social të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Në fjalën e saj, ajo theksoi se përvoja e Shqipërisë ka treguar se pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara nuk janë vetëm “simbol i drejtësisë në veprim”, por edhe “një burim i ri fuqizimi ekonomik dhe social për grupet në nevojë dhe organizatat e shoqërisë civile”.

“Ne kemi zgjedhur ta shohim ripërdorimin social jo vetëm si një mjet simbolik, por si një instrument të qëndrueshmërisë financiare. Përmes dhënies në përdorim të aseteve të konfiskuara, organizatat kanë krijuar të ardhura që u mundësojnë të rrisin kapacitetet e tyre, të ofrojnë shërbime mëcilësore dhe të mbeten të pavarura në veprimtarinë e tyre,” – u shpreh znj. Xhaja.

Ajo solli shembuj konkretë nga Shqipëria, si hapja e bizneseve sociale në pronat e konfiskuara, përdorimi i automjeteve të sekuestruara për shërbime komunitare dhe transformimi i hapësirave publike të zëna dikur nga “varreza makinash” në “hapësira të gjelbra për qytetarët”.

“Secila prej këtyre iniciativave është dëshmi e qartë se pasuritë e marra nga aktivitetet kriminale mund t’i shërbejnë komunitetit dhe të kthehen në një burim legjitim, që forcon shoqërinë civile dhe rrit rezistencën e saj përballë sfidave të kohës, por edhe që i shërbejnë komunitetit dhe në veçanti grupeve vulnerabël,” – nënvizoi ajo.

Gjatë diskutimit, znj. Xhaja theksoi gjithashtu se modeli i Shqipërisë është i përshtatshëm për t’u ndarë edhe me vendete tjera të rajonit:

“Në Ballkanin Perëndimor, ku donatorët ndërkombëtarë kanë qenë mbështetës dhe gjej rastin t’i falenderoj, ndërkohë që shoqëria civile përballlet me presione të shumta, mekanizma të tillë kombëtarë si ripërdorimi social i aseteve të konfiskuara krijojnë një shtyllë të re të qëndrueshmërisë financiare dhe besueshmërisë publike,” – tha ajo.

Paneli ku mori pjesë Kryeadministratorja e AAPSK mbledhje përfaqësues të lartë të Komisionit Evropian, Sida, Fondacionit Shoqëria e Hapur, si dhe aktorë rajonalë dhe evropianë, të cilët ndanë përvojat dhe modelet e tyre për forcimin afatgjatë të shoqërisë civile.

Konferenca Rajonale “Resilient Voices: Civil Society in a Changing Western Balkans” u organizua nga Balkan Civil Society Development Network (BCSDN) dhe Partners Albania for Change and Development, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë. Diskutimet u fokusuan në treçështje kyçe: mbrojtjen e hapësirës qytetare dhe kornizën ligjore, rolin e shoqërisë civile në procesin e integritetit evropian dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë financiare përmes modeleve të reja të mbështetjes.

Ky aktivitet konfirmoi edhe një herë se shoqëria civile në rajon mbetet një aktor thelbësor për demokracinë, reformat dhe procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, duke sjellë zëra të qëndrueshëm përballë sfidave të kohës.

25 Shtator, 2025

Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), znj. Risena Xhaja, mori pjesë në workshopin rajonal të organizuar nga Rrjeti i Agjencive të Menaxhimit të Aseteve në Ballkan (BAMIN), në bashkëpunim me GIZ, në kuadër të projektit EU4FAST.



Takimi me temë “Planifikimi për Menaxhimin Efektiv të Aseteve: Konsiderata përpara sekuestrimit” mbledhi përfaqësues nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vende të tjera anëtare e vëzhguese të BAMIN, për të shkëmbyer praktikat më të mira mbi planifikimin para sekuestrimit të pasurive, si një hap thelbësor për ruajtjen e vlerës së tyre deri në dispozicionin final.

Në fjalën e saj, znj. Xhaja prezantoi progresin e Shqipërisë në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, duke theksuar veçanërisht ripërdorimin social të tyre si një praktikë tashmë të konsoliduar, por me objektiv për t’u zgjeruar më tej.

“Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm përpara në menaxhimin e pasurive të sekuestruara, duke i kthyer ato nga problem i trashëguar në një mundësi për zhvillim social e ekonomik. Sot, pasuritë e konfiskuara, jo vetëm që administrohen, por ato edhe vihen në përdorim, duke i shërbyer komunitetit dhe në veçanti shtresave vulnerabël të shoqërisë. Janë një sërë nismash të ndërmarra falë mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë, që gjej rastin t’i falenderoj, si edhe në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Ne synojmë t’i zgjerojmë më tej këto projekte,” – u shpreh znj. Xhaja.

Ajo vuri në dukje rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimit të praktikave më të mira, ndërsa shtoi se përvoja shqiptare po shërben gjithnjë e më shumë si model për disa vende të rajonit.

“Ripërdorimi social i pasurive të konfiskuara është një vlerë e shtuar që ne kemi zgjedhur ta promovojmë, sepse kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e besimit të qytetarëve tek drejtësia dhe shteti i së drejtës,” – theksoi Kryeadministratorja e AAPSK.

Workshopi u fokusua në kuptimin e standardeve të reja të BE-së dhe FATF-it mbi menaxhimin e pasurive, analizimin e praktikave aktuale në rajon dhe identifikimin e barrierave që pengojnë zbatimin e suksesshëm të planifikimit para sekuestrimit. Konkluzionet dhe rekomandimet e këtij workshopi do t’i shërbejnë aktorëve rajonalë për të forcuar më tej kapacitetet e tyre në këtë fushë.

19 Shtator, 2025

Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Risen Xhaja, zhvilloi sot një vizitë në pastiçerinë “Ke Bueno” në Fier, një sipërmarrje sociale e ngritur në një pronë të konfiskuar nga aktivitetet kriminale.



Znj. Xhaja u shpreh se AAPSK po intensifikon përpjekjet dhe bashkëpunimet me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat vendase për të zgjeruar nisma të ngjashme, duke kthyer pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara në funksion të komunitetit.

“Ky biznes i inauguruar në vitin 2018 ishte mes të parëve pjesë e një projekti të suksesshëm për të vënë në funksion të komunitetit dhe në veçanti shtresave vulnerabël pasuritë e krimit të organizuar. AAPSK ka shtuar së fundmi përpjekjet dhe bashkëpunimet për të zgjeruar edhe më tej nisma të tilla, në funksion të ripërdorimit social të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara në shërbim të komunitetit,” – deklaroi Xhaja.

Pastiçeria sociale “Ke Bueno” është iniciativa e parë e këtij lloji në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor. Ajo ofron punësim dhe mbështetje për persona në nevojë – të rinj të rrezikuar nga përfshirja në krim, individë që vuajnë shërbimin e provës, si dhe gra viktime të dhunës ose të divorcuara – duke i ndihmuar të rigjejnë dinjitetin dhe të integrohen në shoqëri.

Ky model shihet si një hap konkret drejt ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara dhe si një mënyrë për të forcuar besimin e qytetarëve se pasuritë e përfituara nga krimi mund t’i rikthehen shoqërisë.

18 Shtator, 2025

Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, znj. Risena Xhaja priti në një takim pune z. Martin Schaller, Zëvendësambasador i Austrisë, si dhe z. Andreas Nagy, atashe policor pranë Ambasadës Austriake në Tiranë.



Gjatë takimit u diskutua mbi vizionin strategjik dhe arritjet e deritanishme të Agjencisë në drejtim të administrimit efektiv të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si një instrument thelbësor në luftën kundër krimit të organizuar. Në këtë kuadër, palët shkëmbyen ide mbi format konkrete

të mbështetjes dhe bashkëpunimit me autoritetet austriake, me qëllim forcimin e mëtejshëm të mekanizmave institucionale dhe rritjen e efikasitetit në këtë fushë.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua:

- forcimit të kapaciteteve institucionale përmes trajnimeve dhe asistencës teknike;
- shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e sigurisë dhe menaxhimit të pasurive; si edhe
- zhvillimit të projekteve të përbashkëta që synojnë rritjen e transparencës dhe eficiencës, përfshirë edhe aspektin e ripërdorimit social të pasurive në funksion të interesit publik.

AAPSK vlerëson lart mbështetjen e vazhdueshme të Austrisë, si një partner i rëndësishëm në konsolidimin e sundimit të ligjit, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në rritjen e efektivitetit të përpjekjeve të përbashkëta kundër krimit të organizuar.

Në përfundim, palët theksuan angazhimin e qartë për të vijuar në një front të përbashkët kundër krimit të organizuar, duke vendosur theks të veçantë tek bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, si një domosdoshmëri për garantimin e sigurisë dhe forcimin e rendit demokratik.

17 Shtator, 2025

Sot, në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, patëm kënaqësinë të presim përfaqësues të Ambasadës Britanike në Kosovë dhe të Agjencisë Kombëtare kundër Krimit (NCA) në Tiranë, Z. Edward Orr dhe Z. Shpat Balaj.

Takimi u zhvillua në kuadër të përfshirjes së AAPSK në projektin rajonal ku marrin pjesë Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, me synim forcimin e bashkëpunimit në zbatimin e ligjit dhe luftën kundër krimit të organizuar.

Fokusi i diskutimeve ishte tek:

- Krimet kibernetike dhe kriptovalutat
- Rritja e kapaciteteve hetimore në fushën digjitale
- Përmirësimi i kuadrit ligjor mbi të cilin veprojnë agjencitë homologe



Ky bashkëpunim përbën një hap të rëndësishëm drejt një rajoni më të sigurt dhe më të përgatitur për sfidat e kohës.

16 Shtator, 2025

Ish-reparti ushtarak në Bërdicë, një hapësirë e mbuluar prej dekadash nga tonelata hekurishte dhe qindra automjete të bllokuara, po i rikthehet më në fund qytetarëve të Shkodrës. Pas vendimit të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronës në administrim të Bashkisë Shkodër, punimet për pastrimin e zonës tashmë kanë përfunduar, duke hapur rrugën për një transformim të madh urban.



Nga pikë mjeteve të bllokuara në park lojërash




Nga A2 CNN

15 Shtator 2025, 18:45 | Aktualitet



Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Risena Xhaja dhe kryetari i bashkisë Shkodër, Benet Beci inspektuan nga afër terrenin, i cili deri pak javë më parë shërbente si magazinë e improvizuar e automjeteve të bllokuara nga policia, ndërsa së fundmi u mor nën administrim nga AAPSK.



“Janë rreth 327 automjete dhe motomjete që janë hequr nga kjo zonë dhe janë grumbulluar në Porto Romano. Pjesa tjetër e skrapit ishte e mbetur prej më shumë se 12 vitesh. Sot kjo hapësirë është e lirë dhe gati për investim”, tha znj. Xhaja.

Në total, bëhet fjalë për tre hektarë tokë që do të kthehen në hapësirën më të madhe publike të qytetit, një projekt i përbashkët mes Bashkisë Shkodër dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Projekti parashikon ndërtimin e një këndi lojërash modern për fëmijë, hapësira rekreacioni për prindërit, si dhe gjelbërim që do t’i japë frymëmarrje një prej zonave të bllokuara prej dekadash.

Për kryebashkiakun Beci, ky është një transformim i rëndësishëm jo vetëm nga ana vizuale, por edhe për funksionalitetin urban të Shkodrës:

“Ky është një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm për qytetin tonë. Për 30 vjet, kjo hapësirë ka qenë e zaptuar nga makina të ndryshkura dhe nuk kishte asnjë vlerë për qytetarët. Sot e kemi çliruar dhe do ta kthejmë në një park për fëmijët e Shkodrës. Është një dhuratë për komunitetin dhe një premtim që po e bëjmë realitet.”

Ky investim pritet të nisë së shpejti, duke i hapur rrugën parkut më të madh të lojërave në Shkodër, një hapësirë që jo vetëm do të gjallërojë jetën e banorëve, por do të kthehet edhe në një simbol të transformimit të qytetit drejt standardeve moderne urbane.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) shpall hapjen e projektit “PUBLIK”, një iniciativë e veçantë që shndërron një hapësirë të konfiskuar nga krimi i organizuar në galeri arti, qendër komunitare dhe hapësirë edukimi artistik e teknologjik. Ky projekt, i pari i këtij lloji në Shqipëri dhe ndër më të veçantët në rajon, është në linjë me filozofinë dhe objektivat e AAPSK për të rikthyer në dobi të publikut pasuritë e krimit.



Fokusi i projektit shkon përtej artdashësve. PUBLIK i kushtohet veçanërisht grupeve më vulnerabël të shoqërisë – fëmijëve të policëve të rënë në detyrë, grave viktime të dhunës dhe trafikimit, të rinjve të ekspozuar ndaj kulturës incel, personave me aftësi ndryshe dhe komuniteteve të marginalizuara. Çdo artist që ekspozon në PUBLIK angazhohet njëkohësisht në punë krijuese me një kategori vulnerabël, duke e kthyer artin në mjet fuqizues dhe shërues.

Në partneritet me Ministrinë e Arsimit, projekti do të ofrojë gjithashtu programe edukative për shkollat, duke integruar artin në përvojën e hershme të fëmijëve dhe duke ndërtuar ura të reja mes edukimit dhe kulturës.

Kryeadministratorja e AAPSK, znj. Risena Xhaja, me nënshkrimin e marrëveshjes me drejtuesit e projektit, theksoi rëndësinë e këtij transformimi:

“Ky projekt është një tjetër shembull domethënës i misionit tonë – të kthejmë pasuritë e konfiskuara nga krimi në shërbim të qytetarëve. Kjo është një nismë e veçantë, pasi bashkon artin me përfshirjen dhe integrimin e grupeve vulnerabël të shoqërisë dhe është projekti i parë i këtij lloji që implementohet në Shqipëri.”

Hapja e parë e PUBLIK do të zhvillohet në tetor 2025, nën drejtimin e artistes Blerta Kambo, me një ekspozitë dhe aktivitete të dedikuara për komunitetin. Projekti është konceptuar si një nismë afatgjatë, që synon të zgjerohet edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, duke e kthyer përdorimin

social të pasurive të konfiskuara në një instrument të fuqishëm transformimi dhe emancipimi shoqëror.

26 Gusht, 2025

AAPSK dhe UNICEF Shqipëri nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për transformimin e pasurive të konfiskuara në hapësira sociale për fëmijët dhe komunitetin



Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe UNICEF Shqipëri nënshkruan sot një Marrëveshje Bashkëpunimi me qëllim transformimin e pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar në hapësira të dobishme për fëmijët, të rinjtë dhe komunitetin.

Kjo marrëveshje synon që pasuritë e konfiskuara të shndërrohen në qendra dhe mjedise sociale që promovojnë të drejtat e fëmijëve, ofrojnë shërbime dhe mundësi për të rinjtë, si edhe fuqizojnë komunitetin në luftën për një shoqëri më të drejtë, të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Bashkëpunimi parashikon identifikimin dhe vënien në dispozicion të pasurive të konfiskuara nga AAPSK, ndërsa UNICEF Shqipëri do të ofrojë ekspertizën ndërkombëtare, praktikat më të mira dhe mbështetjen teknike për t'i transformuar këto pasuri në modele funksionale që i shërbejnë zhvillimit social.

Kryeadministratorja e AAPSK, znj. Risena Xhaja, theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi:

“Sot hedhim një hap të madh përpara në kthimin e pasurive të konfiskuara në vlerë të prekshme për fëmijët, të rinjtë dhe gjithë shoqërinë. Nëpërmjet këtij partneriteti me UNICEF Shqipëri, ne jo vetëm që i japim një destinacion të ri këtyre pasurive, por ndërtojmë hapësira ku fëmijët dhe të rinjtë ndihen të mbrojtur, të përfshirë dhe të fuqizuar. Ky proces është një shembull konkret i mënyrës sesi drejtësia mund të shndërrohet në mundësi për komunitetin.”

Nga ana e tij, Përfaqësuesi i UNICEF Shqipëri, z. Murat Sahin, vuri në dukje se kjo marrëveshje është në linjë me angazhimin e UNICEF për të mbështetur të drejtat e fëmijëve në Shqipëri:

“Transformimi i pasurive të konfiskuara në hapësira për fëmijët dhe komunitetin është një nga mënyrat më të forta për të kthyer drejtësinë sociale në realitet. UNICEF është i angazhuar të bashkëpunojë me AAPSK në këtë nismë, duke sjellë ekspertizën dhe përvojën ndërkombëtare për të krijuar mjedise që u japin fëmijëve mundësi të reja për të mësuar, për t'u zhvilluar dhe për t'u përfshirë në jetën shoqërore. Ky është një investim i drejtpërdrejtë për të ardhmen e vendit.”

Marrëveshja e nënshkruar do të shërbejë si bazë për një sërë iniciativash të përbashkëta, përfshirë krijimin e qendrave komunitare në pasuritë e konfiskuara; programe të dedikuara për fëmijët dhe të rinjtë në fusha si edukimi, shëndeti mendor dhe përfshirja sociale; fuqizimin e organizatave vendore për të menaxhuar dhe mirëmbajtur këto hapësira; si edhe ngritjen e modeleve të qëndrueshme të ripërdorimit social që mund të shërbejnë si shembull edhe në rajon.

1. Ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm në kthimin e pasurive të konfiskuara nga krimi në një aset të përbashkët për shoqërinë shqiptare. Ai përforcon mesazhin se pasuritë e përfituara në mënyrë të paligjshme mund dhe duhet të rikthehen si burim i zhvillimit dhe i shpresës për brezat e rinj.

Kryeadministratorja e AAPSK në Qendrën Psiko-Sociale “Vatra” në Vlorë: Më shumë nisma për ripërdorimin social të pasurive të sekuestruara



Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), znj. Risena Xhaja, zhvilloi ditën e sotme një vizitë pranë Qendrës Psiko-Sociale “Vatra” në qytetin e Vlorës, një nga projektet e suksesshme të ripërdorimit social të pasurive të sekuestruaranga krimi i organizuar.

Gjatë takimit me drejtuesit dhe stafin e qendrës, u vlerësua puna e gjatë dhe përkushtimi i “Vatrës” në mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Që nga themelimi i saj në vitin 1999, kjo qendër ka asistuar mijëra gra, vajza dhe fëmijë në nevojë, duke ofruar shërbime rezidenciale dhe komunitare, mbështetje psikologjike, sociale, ligjore dhe edukative.

Kryeadministratorja Xhaja theksoi se modeli i “Vatrës” përbën një shembull frymëzues të mënyrës sesi pasuritë e sekuestruara mund të kthehen në vlerë publike, duke u vënë në shërbim të komunitetit dhe grupeve më vulnerabël të shoqërisë.

“Ky është një nga rastet ku pasuritë e sekuestruara nga krimi i organizuar shndërrohen në hapësira të dobishme për qytetarët, duke kontribuar drejtpërdrejt në mbrojtjen e jetës dhe dinjitetit të njerëzve. Qëllimi ynë është të zgjerojmë më tej këtë nismë, duke i dhënë gjithnjë e më shumë pasurive të tilla një funksion social dhe komunitar,” – u shpreh znj. Xhaja.

AAPSK është e angazhuar të rrisë numrin e projekteve të ngjashme në të gjithë vendin, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, pushtetin vendor dhe partnerët ndërkombëtarë, duke e kthyer ripërdorimin social të pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara në një mekanizëm të qëndrueshëm për forcimin e shtetit të së drejtës dhe mbështetjen e komuniteteve lokale.

28 Korrik, 2025

AAPSK jep në përdorim mjet transporti për Shtëpinë e Fëmijës në Bashkinë Shkodër!



Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) ka vënë në dispozicion një automjet transporti (furgon) për nevojat e Shtëpisë së Fëmijës në Bashkinë Shkodër, i cili do të përdoret për transportin e fëmijëve që ndodhen në përkujdesje institucionale.

Kjo është një nga nismat më të fundit në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit institucional me njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim përdorimin e pasurive të konfiskuara në funksion të qëllimeve sociale.

Vendosja në dispozicion e mjetit për Bashkinë Shkodër përbën një hap të parë drejt thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy institucioneve, me synimin për të garantuar kushte më të mira për fëmijët në kujdes institucional, si dhe për shtresat e tjera në nevojë.

Ky rast pason një tjetër iniciativë me Bashkinë Bulqizë, ku AAPSK ka transferuar me kalim kapitali pa pagesë një automjet që do të përdoret për ofrimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët me aftësi ndryshe në zonat e thella të kësaj bashkie.

Këto raste përfaqësojnë shembuj konkretë të transformimit të pasurive të përfituara nga krimi në instrumente në shërbim të një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të shtresave vulnerabël.

AAPSK do të vijojë të bashkëpunojë ngushtë me institucionet qendrore dhe vendore për të zgjeruar rastet e përdorimit të pasurive të konfiskuara në shërbim të interesit publik.

24 Korrik, 2025

AAPSK merr pjesë në Workshop-in Rajonal mbi Rikuperimin e Aseteve, organizuar nga UNODC në Tiranë



Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara , znj. Risena Xhaja, mori pjesë në workshop-in dyditor të organizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC), i zhvilluar më 22–23 Korrik në Tiranë, me fokus në forcimin e mekanizmave për rikuperimin dhe menaxhimin e asetëve me origjinë kriminale.

Gjatë diskutimeve mbi menaxhimin e pasurive pas konfiskimit dhe iniciativat për ripërdorim social, znj. Xhaja prezantoi përvojën shqiptare në këtë drejtim, duke ndarë shembuj konkretë të pasurive të konfiskuara që janë vendosur në funksion të interesit publik.

“Ripërdorimi social i pasurive të konfiskuara është jo vetëm një mënyrë efektive për të kthyer drejtësinë në komunitet, por edhe një mundësi për të ndërtuar besimin e qytetarëve te institucionet,” – u shpreh znj. Xhaja, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstytucional në këtë proces.

Xhaja shprehu gadishmërinë e AAPSK për të forcuar më tej bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë, si edhe me aktorët e tjerë vendas, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të projekteve dhe nismave për ripërdorimin social të pasurive të konfiskuara.

Kryeadministratorja e AAPSK vuri gjithashtu në dukje rëndësinë e ndarjes së përvojave midis vendeve të rajonit dhe më gjerë, si edhe nevojën për të thelluar më tej bashkëpunimin rajonal, me qëllim ngritjen e kapaciteteve teknike dhe institucionale në këtë fushë.

Workshop-i i organizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) mbledhi në Tiranë përfaqësues nga agjencitë e menaxhimit dhe rikuperimit të aseteve nga vendet e rajonit, përfshirë Bosnje-Hercegovinën, Kosovën dhe Shqipërinë. Gjatë dy ditëve të punimeve, ekspertë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të institucioneve ligjzbatuese ndanë përvojat më të mira dhe nxitën dialogun për forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar në luftën kundër krimit të organizuar dhe pasurive me origjinë të paligjshme.

23 Korrik, 2025

Ambulanca të reja për burgjet – AAPSK në mbështetje të forcimit të kapaciteteve të strukturave ligjzbatuese



Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) ka mbështetur Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të përmirësuar më tej infrastrukturën dhe mjetet në dispozicion, përmes autoambulancave të reja të kategorisë A.

15 mjetet e reja, të gjitha prodhim i vitit 2025, të dedikuara për transportin e të dënuarve apo të paraburgosurve që përballen me probleme shëndetësore, janë pjesë e një projekti për modernizimin e flotës mjekësore në sistemin penitenciar shqiptar.

Projekti është financuar nga fondi i posaçëm në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), me vendimin e marrë nga Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar. Nëpërmjet këtij vendimi u mundësua financimi i furnizimit të DPP me 8 ambulanca të kategorisë A, si pjesë e angazhimit për të vendosur pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara nga krimi në funksion të strukturave ligjzbatuese dhe në shërbim të komunitetit.

Mjetet do të shpërndahen në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit në vend, duke forcuar kapacitetet logjistike dhe përkujdesjen shëndetësore për të dënuarit dhe të paraburgosurit.

AAPSK vijon të luajë një rol kyç në përdorimin me efektivitet të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, duke i shndërruar ato në mekanizma për forcimin e shtetit ligjor, përmirësimin e infrastrukturës së institucioneve publike, si dhe gjenerimin e të ardhurave për buxhetin e shtetit. Kjo është një ndër mënyrat më efikase për të rritur ndikimin e drejtësisë në shoqëri dhe për të siguruar që pasuritë e përfituara nga veprimtaria kriminale të shndërrohen në burime të vlefshme për interesin publik.

11 Korrik, 2025

AAPSK dhe GIZ organizojnë workshop trajnues për kryptoasetet dhe asetet virtuale



Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), me mbështetjen e projektit EU4LAW ENFORCEMENT, të financuar nga Bashkimi European dhe Qeveria Gjermane, finalizoi sot workshop-in treditor mbi Kriptovalutat dhe Asetet Virtuale, me fokus të veçantë mbi menaxhimin e kryptoaseteve në kuadër të sekuestrimit dhe konfiskimit.

Ky aktivitet trajnues, i zhvilluar me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë si Richard Strike dhe Andrew Tennant, synoi të rrisë kapacitetet e stafit të AAPSK-së dhe administratorëve të përfshirë në menaxhimin e pasurive dixhitale, përfshirë mënyrat e gjurmimit, sekuestrimit dhe ruajtjes së sigurt të krypto-aseteve.

Trajnimi përfshiu tema thelbësore si ndryshimi mes valutave tradicionale (FIAT) dhe kriptovalutave, struktura e portofolëve dixhitalë dhe siguria e “recovery seeds”, teknologjia blockchain dhe kriptografia, si dhe legjislacioni ndërkombëtar për VASP-et dhe rreziqet e pastrimit të parave përmes kryptoaseteve.

Gjatë sesioneve të workshop-it, vëmendje e veçantë iu kushtua proceseve të sekuestrimit, ruajtjes dhe realizimit të kryptoaseteve, duke u ndalur edhe në mekanizmat për ruajtje vlerës, rritjen e përfitimeve dhe strategjitë e sigurta të shitjesapo konvertimit të tyre.

Ky aktivitet vjen në vijim të trajnimit të mëparshëm të zhvilluar në bashkëpunim me UNICEF dhe është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të AAPSK për të siguruar administrimin profesional dhe të përditësuar të pasurive të sekuestruara apo konfiskuara, në përputhje me zhvillimet më të fundit teknologjike dhe standardet ndërkombëtare.

26 Qershor, 2025

Përmbyllet projekti “Toka Jonë”, pasuritë e konfiskuara, në shërbim të drejtësisë sociale dhe zhvillimit rural



26 Qershor, 2025

Sot në Tiranë u zhvillua Konferenca Përmbyllëse e projektit “Toka Jonë”, një nismë novatore për ripërdorimin social të tokave të konfiskuara nga krimi i organizuar në Shqipëri. Projekti, i zbatuar nga COSV në partneritet me ANRD dhe CGM dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), u financua nga Komisioni Evropian dhe është zbatuar që nga viti 2022 në zona rurale si Shijaku dhe Tirana.

Kryeadministratorja e AAPSK, znj. Risena Xhaja, në fjalën e saj përshëndetëse, theksoi rëndësinë strategjike që përfaqëson ky projekt për vetë misionin e agjencisë: “Projekti ‘Toka Jonë’ ka qenë më shumë se një ndërhyrje konkrete – ka qenë një eksperiencë e vlefshme mësimi, bashkëpunimi dhe rritjeje institucionale.”

Ajo theksoi se falë këtij bashkëpunimi, toka të konfiskuara janë kthyer në burime të punësimit, zhvillimit social dhe integritetit për grupe të marginalizuara në zonat rurale.


Gjatë zbatimit të projektit, AAPSK është përballur edhe me sfida të rëndësishme, të cilat kanë shërbyer për të përmirësuar proceset e brendshme. Një prej tyre ishte përballja me problematika pronësie, e cila sipas znj. Xhaja “i dha shtysë agjencisë për të forcuar standardet e vlerësimit të riskut dhe për të garantuar më shumë siguri për organizatat dhe komunitetet që ndërtojnë mbi këto pasuri.”

Znj. Xhaja theksoi gjithashtu se projekti ka ndihmuar në afrimin e AAPSK me standardet më të mira evropiane për qeverisjen e aseteve të konfiskuara, duke forcuar më tej partneritetin ndërinstytucional dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile.

Në përfundim të fjalës së saj, Kryeadministratorjashprehu mirënjohjen për të gjithë partnerët e projektit dhe për Komisionin Evropian, duke ritheksuar angazhimin e AAPSK për të avancuar më tej në misionin e saj për përdorimin me qëllim social të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës dhe besimit qytetar tek institucionet publike.

19 Qershor, 2025

AAPSK dhe UNICEF fuqizojnë bashkëpunimin, trajnim për kriptomonedhat për përdorimin me impakt social





Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), në bashkëpunim me UNICEF Shqipëri, organizoi një trajnim për ndërtimin e kapaciteteve të stafit të AAPSK në identifikimin e zgjidhjeve inovative përmes modelit Human-Centered Design të UPSHIFT, me theks të veçantë në menaxhimin e kriptomonedhave për impakt social.

Kjo nismë vjen si pjesë e një partneriteti të vazhdueshëm mes dy institucioneve që synon shfrytëzimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara për qëllime sociale, veçanërisht në ndihmë të fëmijëve në nevojë. Në trajnimin e fokusuar në përdorimin e kriptove në shërbim të kauzave sociale morën pjesë rreth 21 punonjës nga AAPSK dhe institucionet e tjera ligjzbatuese.

Në hapje të aktivitetit përshëndetën znj. Risena Xhaja, Kryeadministratore e AAPSK-së, z. Murat Sahin, Përfaqësues i UNICEF në Shqipëri, si dhe z. Christopher Fabian nga GIGA – Zyra Globale për Inovacionin e UNICEF.

Ky trajnim përfshiu njohuri bazë mbi funksionimin e teknologjisë blockchain dhe portofolëve dixhitalë, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për përdorimin e fondeve në krypto për impakt të drejtpërdrejtë social. Në fokus të veçantë ishte krijimi i një “Crypto Reserve Fund for Children”, një model unik që synon të kthejë pasuritë dixhitale të konfiskuara në fonde që mbështesin mirëqenien dhe të drejtat e fëmijëve në Shqipëri.

10 Qershor, 2025

AAPSK dhuron një automjet për shërbime sociale në ndihmë të fëmijëve me aftësi ndryshe në Bashkinë Bulqizë



Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) ka transferuar me kalim kapitali pa pagesë një automjet në favor të Bashkisë Bulqizë, për t'u përdorur në ofrimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët me aftësi ndryshe në zonat e thella të kësaj bashkie.

Automjeti, pjesë e flotës së pasurive të konfiskuara që administrohen nga AAPSK, do të vihet në funksion të projektit social të mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që ka për synim ofrimin e terapive dhe shërbimeve të kujdesit në banesë për fëmijë me aftësi të kufizuara.

E pranishme në ceremoninë e dorëzimit të automjetit, Kryeadministratorja e AAPSK, znj. Risena Xhaja falënderoi Komitetin Ndërinstitucional për masat kundër krimit të organizuar për gadishmërinë e treguar për të mbështetur këtë nismë sociale dhe theksoi se institucioni që drejton mbetet i angazhuar për të kontribuar në ndihmë të komunitetit dhe shtresave në nevojë.

Kryetarja e Bashkisë Bulqizë, znj. Festime Mjeshtri vlerësoi AAPSK për ndihmën dhe theksoi se mjeti i transportit do të jetë shumë i vlefshëm për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi ndryshe, sidomos atyre që jetojnë në zonat e thella të Bashkisë Bulqizë.

Kjo mbështetje për Bashkinë Bulqizë do të ndihmojë në përmirësimin e aksesit në shërbime për rreth 50 fëmijë, të cilëve u ofrohet ndihmë e drejtpërdrejtë në ambientin ku jetojnë, përmes një ekipi profesionistësh lëvizës.

Ky akt i AAPSK është një shembull konkret i kthimit të pasurive të konfiskuara në funksion të mirëqenies sociale dhe mbrojtjes së grupeve në nevojë, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Automjeti do të përdoret ekskluzivisht për qëllime sociale dhe do të mbajë logon e AAPSK, Bashkisë Bulqizë dhe partnerit implementues, Fondacionit Joscelyn.

3 Qershor, 2025

Shqipëria, bashkëpunim dhe asistencë Kosovës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara



Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) priti një delegacion zyrtar nga institucioni homolog i Republikës së Kosovës, i cili zhvilloi një vizitë dy-ditore në vendin tonë, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit në fushën e administrimit të pasurive me burim të paligjshëm dhe të rikthimit të tyre në funksion të publikut.

Takimet dypalëshe u zhvilluan në një atmosferë të hapur dhe bashkëpunuese, ku u shkëmbyen përvoja, modele pune dhe praktika të suksesshme për:

- Standartizimin e procedurave të administrimit të pasurive;
- Rritjen e transparencës dhe efikasitetit institucional;
- Zhvillimin e formave të reja të ripërdorimit social të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Delegacioni nga Kosova vizitoi një ndërmarrje sociale në Elbasan, e ngritur në një pasuri të konfiskuar dhe tashmë e funksionalizuar si një qendër pune dhe përfshirjeje për komunitetin. Ky projekt konkret është rezultat i një vizioni të qartë për transformimin e pasurive të paligjshme në mundësi sociale dhe ekonomike për qytetarët më në nevojë.

Kryeadministratorja e AAPSK-së, znj. Risena Xhaja, theksoi:

“Kjo vizitë është dëshmi e qartë se besimi dhe vullneti për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale përtej kufijve po jep fryte konkrete. AAPSK është e angazhuar për të thelluar më tej bashkëpunimin rajonal dhe për të përfituar nga praktikat më të mira evropiane. Kemi rënë dakord me AAPSK-në e Kosovës për të nënshkruar së shpejti një marrëveshje të re bashkëpunimi. Rasti i sipërmarrjes sociale në Elbasan tregon se pasuritë e konfiskuara mund të kthehen në motor zhvillimi dhe përfshirjeje për grupet në nevojë.”

Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, z. Alban Sutaj, deklaroi:

“Mësimet dhe modelet që pamë gjatë kësaj vizite, veçanërisht projektet sociale të zhvilluara në prona të konfiskuara, janë frymëzim për të ndërtuar struktura të qëndrueshme edhe në Kosovë. Jemi të përkushtuar që marrëveshja dypalëshe që po përgatitet të jetë një themel i fortë për bashkëpunim të qëndrueshëm.”

Në përmbyllje të vizitës, palët ritheksuan angazhimin për të finalizuar nënshkrimin e një marrëveshjeje zyrtare bashkëpunimi, e cila do të përfshijë:

- Shkëmbimin e të dhënave dhe praktikave më të mira;
- Bashkërendimin në rastet me elemente ndërkufitare;
- Mbështetjen reciproke në zhvillimin e politikave të ripërdorimit social dhe transparencës.

Ky bashkëpunim është një hap konkret drejt ndërtimit të një modeli të qëndrueshëm dhe të integruar rajonal për administrimin e pasurive me origjinë kriminale dhe shndërrimin e tyre në burime në dobi të shoqërisë.

30 Maj, 2025

Shqipëria dhe Ukraina forcojnë bashkëpunimin për menaxhimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara



Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara e Republikës së Shqipërisë (AAPSK) dhe Agjencia Kombëtare e Ukrainës për Gjetjen, Gjurmimin dhe Menaxhimin e Pasurive që Rrjedhin nga Korrupsioni dhe Krime të Tjera (ARMA) nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim forcimin e lidhjeve institucionale dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Marrëveshja u nënshkrua në Varshavë, ku të dy vendet morën pjesë në Forumin IV Ligjor BE-Partneriteti Lindor, nga Znj. Risena Xhaja, Kryeadministratore e AAPSK-së, dhe Znj. Olena Duma, Drejtoreshë e ARMA-s, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një platforme të përbashkët për rritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimeve të tjera me ndikim ekonomik.

Dokumenti parashikon bashkëpunim në fusha si:

- shkëmbimi i praktikave më të mira për menaxhimin dhe ripërdorimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;
- organizimi i seminareve, webinarëve dhe forumeve të përbashkëta;
- krijimi i grupeve të përbashkëta pune dhe projekteve kërkimore;

- zhvillimi i marrëdhënieve me organizata ndërkombëtare.

Në deklaratën e saj, Znj. Xhaja theksoi: “Kjo marrëveshje shënon jo vetëm një bashkëpunim teknik, por edhe një angazhim të përbashkët për forcimin e shtetit të së drejtës dhe përdorimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara në dobi të publikut.”

Nga ana e saj, Znj. Duma vlerësoi forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në rritjen e kapaciteteve dhe efikasitetit institucional: “Partneritetet si ky janë thelbësore për të siguruar një qasje të koordinuar dhe efektive ndaj pasurive të paligjshme në nivel ndërkombëtar.”

Marrëveshja hyn në fuqi menjëherë dhe do të shërbejë si bazë për shkëmbim informacioni dhe zhvillimin e një sërë aktiviteteve të përbashkëta për periudhën në vazhdim.

29 Maj, 2025

Kryeadministratorja e AAPSK: Thellojmë bashkëpunimin, përafrim me praktikat më të mira evropiane



Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), znj. Risena Xhaja, mori pjesë në Forumin e Katërt Ligjor BE-Partneriteti Lindor, i cili u mbajt në Varshavë, Poloni. Ky forum mbledhi përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet

shtetërore, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe organizatat ndërkombëtare për të diskutuar rreth forcimit praktikave më të mira për rikuperimin dhe administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar në vendet e rajonit dhe më gjerë.

Gjatë ndërhyrjes së saj në panel, znj. Xhaja prezantoi përvojën dhe praktikën që AAPSK ka zhvilluar në administrimin efektiv të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara në Shqipëri, si një komponent thelbësor në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ajo theksoi rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të Agjencisë në sigurimin e integritetit dhe transparencës së procesit të administrimit të pasurive, duke vënë në dukje progresin e bërë me hartimin e Manualit të Procedurave për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara – një dokument kyç që standardizon hapat institucionalë dhe garanton një trajtim të barabartë dhe ligjor për çdo kategori pasurie të administruar nga AAPSK.

“Nëpërmjet këtij manuali, ne krijojmë një kornizë të qartë për administrimin e pasurive, që përfshin procedura të hollësishme për marrjen në administrim, ruajtjen, përdorimin e përkohshëm, apo shitjen e pasurive në përputhje me vendimet e organeve kompetente,” – deklaroi znj. Xhaja. “Ky është një hap vendimtar drejt rritjes së profesionalizimit dhe harmonizimit të praktikave tona me standardet e Bashkimit Evropian.”

Në vijim, ajo u ndal edhe në sfidat që lidhen me menaxhimin e pasurive komplekse si biznese aktive apo pasuri me vlerë të lartë dhe nevojën për bashkëpunim të ngushtë me institucionet e drejtësisë, policinë, tatimet dhe njësitë hetimore financiare për një proces efikas dhe të paanshëm.

Kryeadministratorja e AAPSK vuri gjithashtu në dukje rëndësinë e ndarjes së përvojave midis vendeve pjesëmarrëse dhe nevojën për të thelluar më tej bashkëpunimin rajonal, me qëllim ngritjen e kapaciteteve teknike dhe institucionale në këtë fushë.

Pjesëmarrja e AAPSK në këtë forum nënvizon angazhimin e Shqipërisë për të qenë pjesë aktive e përpjekjeve ndërkombëtare në luftën kundër pasurive të paligjshme dhe për të avancuar nëpërmbyshjen e prioriteteve të integritetit evropian, përmes forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmirësimit të mekanizmave të luftës kundër krimit të organizuar.

8 Prill, 2025

AAPSK forcon bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara



Kryeadministratorja e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), znj. Risen Xhaja priti në një takim z. John Tacey, Drejtues për Financat e Paligjshme pranë Njësisë për Ballkanin Perëndimor në Këshillin Kombëtar të Shefave të Policisë (NPCC) të Mbretërisë së Bashkuar.

Takimi u zhvillua në nisje të vizitës zyrtare në Tiranë të ekspertit britanik, në kuadër të angazhimit të AAPSK për të forcuar më tej bashkëpunimin ndërkombëtar dhe implementimin e praktikave më të mira në menaxhimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara.

Takimi pason diskutimet e zhvilluara mes palëve në kuadër të vizitës zyrtare të AAPSK muajin e kaluar në Londër dhe përcakton modalitetet për forcimin e bashkëpunimit me autoritetet britanike, si edhe rritjen e mbështetjes së tyre edhe në kuadrin rajonal.

Gjatë takimit u evidentua rëndësia e rritjes së transparencës dhe eficiencës në proceset e administrimit të pasurive, si dhe nevoja për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërshtetëror në këtë fushë. Palët ndanë eksperiencën dhe praktika konkrete mbi funksionimin e mekanizmave respektivë, si dhe identifikuan fusha të mundshme për bashkëpunim të mëtejshëm teknik dhe strategjik.

Ky dialog përfaqëson një hap të rëndësishëm në konsolidimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të AAPSK dhe në përmbushjen e misionit të saj për të garantuar administrimin e drejtë, efikas dhe transparent të pasurive që janë subjekt i masave të sekuestrimit apo konfiskimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet më të mira evropiane.

31 Mars, 2025

Kryeadministratorja e AAPSK, takim me homologët britanikë, bashkëpunim në kuadër të administrimit të kriptomonedhave dhe pasurive dixhitale



Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), znj. Risenaxhaja, është pjesë e delegacionit shqiptar të drejtuar nga Ministri i Brendshëm, Ervin Hoxha, i cili po merr pjesë në Samitin për Sigurinë Kufitare në Mbretërinë e Bashkuar. Gjatë kësaj vizite, znj. Xhaja zhvilloi një takim të rëndësishëm me homologët britanikë, ku morën pjesë shefja e zyrës së “Asset Recovery”, dy prokurorë dhe përfaqësues të kësaj zyre.

Diskutimet u fokusuan në shkëmbimin e përvojave dhe ideve inovative në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, me një vëmendje të veçantë ndaj përdorimit dhe menaxhimit të kriptomonedhave. Në këtë kontekst, palët shprehën gatishmërinë për të forcuar bashkëpunimin në këtë fushë dhe për të ndarë praktikat më të mira për përmirësimin e mekanizmave ekzistues.

Në javën e ardhshme, një nga ekspertët britanikë do të vizitojë Shqipërinë, i cili, përveç pjesëmarrjes në një projekt të përbashkët me Ministrinë e Brendshme, do të finalizojë një takim të rëndësishëm për vendosjen e marrëdhënieve të reja të bashkëpunimit me AAPSK. Një nga objektivat kryesorë të këtij bashkëpunimi është trajnimi i stafit të Agjencisë mbi çështjet që lidhen me kriptomonedhat dhe administrimin e pasurive dixhitale.

Ndërkohë, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të transparencës dhe efektivitetit të administrimit të këtyre pasurive. Javën e kaluar, për herë të parë, u publikua katalogu i pasurive të sekuestruara, një nismë që synon të rrisë transparencën dhe aksesin e publikut në këtë proces. Ky publikim vjen pas katalogut të pasurive të konfiskuara, i cili u prezantua në shkurt të këtij viti, dhe është pjesë e një procesi të gjerë inventarizimi të ndërmarrë nga Agjencia.

Këto zhvillime tregojnë angazhimin e AAPSK për forcimin e kapaciteteve të saj institucionale dhe për të siguruar një administrim më efikas dhe transparent të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

25 Mars, 2025

Kryeadministratorja e AAPSK takon përfaqësues të UNICEF-it në Shqipëri



Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), Znj. Risena Xhaja, së bashku me përfaqësues të agjencisë, pritën në një takim Znj. Linda Bushati, Specialiste për Arsimin dhe të Rinjtë, dhe Znj. Anisa Metalla, Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve nga UNICEF Shqipëri.

Në qendër të diskutimeve ishte mundësia e bashkëpunimit ndërinstitucional për projekte me fokus në arsimin dhe mbrojtjen e shtresave vulnerabël, duke vënë theksin në rëndësinë e rritjes së financimeve dhe mbështetjes për fëmijët, si edhe përfshirjen e sa më shumë aktorëve në

zbatimin e programeve dhe nismave të sukseshme, kjo edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë.

Gjithashtu, u diskutua mbi angazhimin e AAPSK për vendosjen në funksion të komunitetit të pronave të konfiskuara, duke i kthyer ato në hapësira me funksion social, edukativ dhe mbështetës për grupet në nevojë. Këto iniciativa synojnë të krijojnë mundësi të reja për integrimin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve, duke garantuar akses më të gjerë në shërbime cilësore dhe një mjedis të sigurt për ta.

AAPSK do të vijojë bashkëpunimin me organizatat vendase dhe ato ndërkombëtare, me synim implementimin e projekteve dhe nismave të ndryshme me karakter social, nisur edhe nga eksperiencat dhe praktikat më të mira evropiane në këtë fushë.

12 Shkurt, 2025

Ripërdorimi social i pasurive të konfiskuara, Xhaja: Forcim të mekanizmave monitorues dhe rritje të transparencës



Kryeadministratoreshja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, zj. Risena Xhaja ishte e pranishme në panelin e parë të diskutimeve të Konferencës Ndërkombëtare “Nga fitimet e paligjshme të mira publike: e ardhmja e aseteve të konfiskuara”. Konferenca e

organizuar nga “Partners Albania” mbledhi bashkë përfaqësues të agjencive shtetërore përgjegjëse për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, ekspertë të huaj dhe vendas, si edhe aktorë të shoqërisë civile.

Aktiviteti u përshëndet nga Ministri i Brendshëm, z. Ervin Hoxha, i cili vlerësoi punën që po bën Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), edhe sa i përket ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara.

Duke përmendur disa nga rezultatet e arritura nga AAPSK, Ministri Hoxha pohoi se “janë një numër i konsiderueshëm ndërtesash apo ambientesh që janë konfiskuar dhe janë vënë në shërbim të publikut. Madje dhe vetë Agjencia punon sot në zyra të konfiskuara. Qëllimi ynë është që asetet e konfiskuara, të ruajnë vlerën e mundësisht të rriten në vlera që të inventarizohen si të mira materiale në shërbim të qytetarëve”.

Kryeadministratorja e AAPSK, zj. Xhaja, gjatë diskutimeve në konferencë u shpreh se pavarësisht sfidave ligjore dhe operacionale gjatë kryerjes së detyrave të saj, Agjencia ka arritur të shtojë të ardhurat nga mirëadministrimi i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara. Zj. Xhaja theksoi se nevojiten përmirësime të mëtejshme ligjore, të cilat duhet të synojnë një kuadër rregullator më të plotë dhe të detajuar për administrimin dhe ripërdorimin e pasurive të konfiskuara.

Sa i përket sfidave operacionale, Kryeadministratorja e AAPSK përmendi burimet e kufizuara njerëzore dhe financiare. “Administrimi i pasurive të konfiskuara është shpesh një proces i ndërlikuar, që kërkon ekspertizë dhe pajisje të specializuara. Agjencia duhet të qëndrojë e përditësuar me praktikën më të mirë dhe zhvillimet teknologjike për të siguruar një menaxhim efikas,” u shpreh zj. Xhaja.

Kryeadministratorja vlerësoi mbështetjen e Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar, si organi mbikëqyrës për veprimtarinë e AAPSK dhe që merr vendime të rëndësishme sa i përket përdorimit efektiv të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara. Për të rritur efektshmërinë e ripërdorimit të pasurive të konfiskuara për përfitime sociale, AAPSK ka identifikuar disa prioritete dhe mekanizma që duhet të forcohen, duke nisur nga përmirësimi i kapaciteteve të Agjencisë, burimet njerëzore, infrastruktura dhe teknologjia, forcimi i mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies, nxitja e mëtejshme e bashkëpunimeve dhe partneriteteve me institucionet e tjera shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile. Zj. Xhaja theksoi gjithashtu nevojën e krijimit të mekanizmave efektivë të monitorimit dhe vlerësimit, si edhe rritjen e informimit dhe përfshirjes më të gjerë të publikut në lidhje me rëndësinë e ripërdorimit të pasurive të konfiskuara për qëllime sociale.

Kryeadministratorja e AAPSK: Rritja e aseteve të konfiskuara, progres në luftën ndaj paligjshmërisë



Kryeadministratorja e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), zj. Risena Xhaja mori pjesë sot, më 11.02.2025, në takimin e 16-të të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria dhe Siguria” mes autoriteteve shqiptare dhe atyre të BE-së, në kuadër të negociatave për anëtarësim.

Takimi u hap nga Ministri i Brendshëm, ndërsa të pranishëm ishin edhe drejtuesja e Njesisë për Zgjerimin, në Komisionin European, zj. Sigrid Brettel, kreu i SPAK, Prokurori i Përgjithshëm, drejtuesi i BKH-së, përfaqësues të Kuvendit e zyrtarë të tjerë të lartë të agjencive ligjzbatuese në vend.

Në fjalën e mbajtur në këtë aktivitet, Kryeadministratorja e AAPSK theksoi rëndësinë e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme, si një aspekt thelbësor në luftën kundër krimit të organizuar. Gjithashtu ajo vuri në dukje nevojën e bashkëpunimit me homologët ndërkombëtarë dhe me strukturat e Bashkimit European.

“Duke punuar ngushtë me ekspertë të këtij sektori dhe gjithashtu me agjenci homologe në shtetet e tjera, ne jemi në gjendje të ndajmë njohuri të çmuara, të rrisim ekspertizën tonë dhe të përmirësojmë menaxhimin e aseteve. Ky bashkëpunim na ka mundësuar të mësojmë nga përvoja e tyre, të rivlerësojmë proceset tona dhe të shfrytëzojmë sa më mirë burimet që kemi në dispozicion, duke siguruar që të qëndrojmë para në luftën kundër krimit të organizuar,” u shpreh zj. Xhaja.

Ajo theksoi se një nga shenjat më të prekshme të progresit të bërë në luftën kundër krimit të organizuar, është rritja e konsiderueshme e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara.

“Ky numër në rritje, është një pasqyrë e qartë e përparimit që kemi bërë në destinimin e pasurisë së paligjshme dhe sigurimin që kriminelët nuk përfitojnë më nga veprimtaritë e tyre,” tha Kryeadministratorja e AAPSK-së.

Zj. Xhaja u shpreh se AAPSK siguron që, pasi asetet të sekuestrohen ose të konfiskohen, ato të menaxhohen siç duhet dhe në mënyrë transparente, me fokus në ruajtjen dhe kthimin e vlerës së tyre në shërbim të komunitetit, nëpërmjet projekteve të ndryshme, si edhe fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit. Në vëmendje janë mbështetja e familjeve të efektiveve të rënë në detyrë, financimi për drejtorinë e përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Prokurorinë, rehabilitimi dhe fuqizimi social i viktimave të trafikimit, përdorimi i aseteve të konfiskuara në shërbim të komunitetit, etj.

Kryeadministratorja e AAPSK u shpreh se institucioni që drejton do të japë kontribut për të forcuar sistemet ligjore, të përmirësojë më tej kapacitetet institucionale dhe të thellojë bashkëpunimin me homologët ndërkombëtarë për të siguruar që asetet kriminale jo vetëm të sekuestrohen, por përfundimisht të konfiskohen dhe të përdoren në funksion të komunitetit.

Fjala e Kryeadministratores së AAPSK, zj. Risena Xhaja, në takimin e 16-të të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria dhe Siguria”

Të nderuar të pranishëm,

Është kënaqësi dhe përgjegjësi e veçantë për mua të flas sot mbi një aspekt thelbësor të luftës kundër krimit të organizuar, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme. Ky është një mjet i fuqishëm, jo vetëm për të ndëshkuar aktivitetet kriminale, por edhe për të rikthyer drejtësinë dhe për të parandaluar fuqizimin e mëtejshëm të grupeve kriminale.

Dua të ndaj me ju progresin e rëndësishëm që Shqipëria ka bërë vitet e fundit në ndjekjen dhe luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe fluksit të paligjshëm të financave që shpesh ushqejnë këto aktivitete.

E konsiderojmë progres të vërtetë zhvillimin e një strukture që na mundëson të identifikojmë, gjurmojmë dhe rikuperojmë asetet që janë fituar në mënyrë të paligjshme. Po ashtu, po krijojmë një strategji për të informuar komunitetin dhe për të qenë gjithmonë transparentë në mënyrën se si kjo strukturë reagon dhe menaxhon këto asete.

Gjatë punës për zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve tona, kundër krimit në çdo aspekt të tij, në kuadër të përafrimit me direktivat e BE, është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi ynë i vazhdueshëm me homologët ndërkombëtarë. Duke punuar ngushtë me ekspertë të këtij sektori dhe gjithashtu me agjenci homologe në shtetet e tjera, ne jemi në gjendje të ndajmë njohuri të

çmuara, të rrisim ekspertizën tonë dhe të përmirësojmë menaxhimin e aseteve. Ky bashkëpunim na ka mundësuar të mësojmë nga përvoja e tyre, të rivlerësojmë proceset tona dhe të shfrytëzojmë sa më mirë burimet që kemi në dispozicion, duke siguruar që të qëndrojmë para në luftën kundër krimit të organizuar.

FALENDERIM

Në përmbyllje, shpreh mirënjohje për të gjithë stafin e AAPSK-së për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar, si dhe për institucionet partnere për bashkëpunimin konstruktiv dhe mbështetjen e vazhdueshme.

Jemi të bindur se, përmes angazhimit të përbashkët dhe respektimit të parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe integritetit, AAPSK do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në forcimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e interesit publik në Republikën e Shqipërisë.

Me respekt,

Risena XHAJA

Kryeadministratore

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK)